

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7839 E martë 2 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Më 4 prill 2019, NATO kremton ditëlindjen e saj të 70-të. Megjithatë, komandanti i saj i parë suprem, Duajt Ajzenhauer, shpeshonte që aleanca të mos i kalonte ...
Vijon në faqen 20

Nga DAVID REYNOLD

NATO në epokën e Putin
dhe Trampit



Analiza *e* **Ditës**

Pashë që 1.2 miliardë euro kontrata PPP të ndërtimit të boshteve të rrugëve që mund të prisnin edhe disa vite për t'u ndërtuar, qeveria i ktheu mbrapsht. Duke ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Dëshirat e 1 prillit



“Kthejmë dinjitetin e Ministrisë së Jashtme”

Konsujt e nderit, Cakaj: 38 emrat të cilëve do t'u hiqen targat diplomatike

“Shkelje e habitshme e ligjit, hyjnë e dalin nga Shqipëria me makina CD”

Ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj, lajmëroi dje një tjetër reformë të rëndësishme, që kërkon t'i rikthejë dinjitetin shërbimit diplomatik dhe institucionit që ai drejton. Vetëm një javë pasi u largua konsulli i Indisë në vendin tonë, i akuzuar për mashtrim, Cakaj ka prezantuar nismën tjetër, atë të heqjes së disa prej privilegjeve që gëzojnë sot konsujt ...
Në faqen 5

LISTA/ TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, FAMILJET QE MARRIN PARATE EMRAT, 500 PRONARET QE PERFITOJNE KOMPENSIMIN

Lista me përfituesit, 6 dokumentet që duhet të dorëzohen në Agjenci. Familjet në Tiranë, Durrës, Berat, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, etj.



(Në foto) Ndërtime informale

KREU I PD

“Vëllezërit Bilal”, Basha-Ramës: Zbardh vrasjet, ose ka gisht shteti
Në faqen 2

REFORMA ZGJEDHORE

Komisioni 3 muaj afat, PS “pranon” shtyrjen e zgjedhjeve vendore?
Në faqen 4

VENDIMET GJYQESORE

Detyrimet e prapambetura, fatura 6.2 miliardë lekë në vitin 2018
Në faqen 7

BURG 4 AUTORET

I grabitën 60 mijë dollarë kambistit, Elvis Tafa: E goditëm me levë në rrugë
Në faqen 10

INTERVISTA NE “NEWS 24”



Vrasjet në Shkodër, Ardi Veliu “jep fjalën”: Ngjarja do zbardhet e plotë
Në faqen 11

Vendimi për përgjysmimin e tarifave për bachelorin. Sa do të paguajë masteri?

Procedura për të marrë paratë e bursës për vitin 2018-2019

“Studentë, drejtohuni pranë zyrave të financës në fakultetet tuaja”

NGA VOLTIZA DURO

Të gjithë ata studentë që iu ka lindur e drejta e përfitimit të bursës, por që nuk e kanë plotësuar dokumentacionin e kërkuar, duhet të paraqiten pranë degëve të Financës së fakulteteve ku studiojnë. Sipas një njoftimi



të publikuar nga Fakulteti i Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës, studentët duhet të dorëzojnë edhe numrat e llogarive të tyre, me qëllim akordimin e bursës. “Studentët kanë të drejtë të marrin bursë sipas dy VKM-ve: VKM nr:903, datë 21.12.2016 ...
Në faqen 12

KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Kreu i PD zbardh opozitinë e opozitës, për zhvendosjen e disa ministrive në rrethe

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, nga Shkodra dhe Malësia e Madhe akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka instaluar një diktaturë të re, atë të kimit. Sipas Bashës, synimi i opozitës është rrënim i sistemit të ngritur prej tij. Gjatë takimeve me shkoderanët, z.Basha u ndesh me problemin e pasigurisë në qytetin e Shkodrës, gjë e cila u deklarua nga përgjegjësi i biznesit të vogël. Njëri nga tregtarët i tregoi Bashës se kanë frikë të dalin në Shkodër, pas ngjarjeve të fundit ku mbetën të vrarë vëllezërit Bilali. "Ke të drejtë të kesh frikë, se këtu bandat të hanë kokën e njëri-tjetrit thotë kryeministri, hënkin kokën e njëri-tjetrit thotë ai. Po ashtu është, edhe policia për çfarë paguhen, për të garantuar sigurinë e qytetarëve", - tha Basha. Ndaj, kreu i PD-së kërkoi që të zbardhet vrasja e vëllezërve Bilali, duke aluduar se pas saj mund të fshihet dhe vetë shteti. "Bandat po hanë kokat e njëri-tjetrit, kjo është përgjigja që jep policia, po policia për çfarë paguhet? Edhe vrasjet duhet të zbardhen, sepse aty ka edhe njerëz të përfshirë në mënyrë të pafajshme. Kjo nuk mund të vazhdojë më kështu, ose përndryshe ka gisht shteti, nuk ka rrugë tjetër. Drejtësi nuk ka, mundësi nuk ka dhe kjo i ka sjellë njerëzit në dëshpërim", theksoi kreu i PD-së. Basha akuzoi se Edi Rama ka instaluar një diktaturë të re, jo më marksiste dhe staliniste, por diktaturë të krimineleve. Kjo është arsyeja pse nuk gjejnë mundësi të rinj të për punësim.

"Beteja që kemi nisur nuk është thjesht për largimin e Edi Ramës", u shpreh z.Basha.

LARGIMI

Kreu i demokratëve, Lulzim Basha, në një takim me banorët e Koplikut deklaroi se largimi i Edi Ramës dhe bandës së tij është emergjencë kombëtare. Sipas tij, opozita pati dy mundësi ose të rreshtojë krah bandës që ndodhet në pushtet ose krah njerëzve të thjeshtë dhe djeja e mandateve provoi se ata janë me popullin e thjeshtë. "Ai është njeri i mbaruar politikisht, regjimi i tij është i mbaruar politikisht. Beteja jonë është për ta shembur regjimin që ai ka ngritur me themel. Me Edi Ramën nuk ka zhvillim, nuk ka përparim ndaj largimi i tij është emergjencë kombëtare, është akt i domosdoshëm. Nuk

"Vëllezërit Bilali", Basha-Ramës: Zbardh vrasjet, ose ka gisht shteti

"Zgjedhje fasadë nuk ka për të pasur më"




Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Koplik

Ministritë

"Tirana dhe Shkodra duhet të lidhen me autostradë me katër korsi dhe distanca të jetë e përshkueshme më shpejt. Pse jo, këtu në Shkodër të vendosen dy ministri, pse jo në Elbasan, Vlorë, Korçë apo Durrës. Asgjë nuk e pengon qeverinë e ardhshme për zhvendosjen e disa institucioneve në disa qytete. E kemi konsideruar si një opion, por programi është ende në fazën e punës" tha Basha.

AKUZA

"Në Dukagjin kemi deputet një ish-trafikan që pastaj është veshur me uniformë policie dhe është kapur pastaj në dosjen 184, duke bërë pazare me Ymer Lalën për të vjedhur bashkinë e Dibërës. Shqipëria e transformuar, Shqipëria e ndryshuar është kjo Shqipëri që do u takojë Elvis Dedëve dhe qindra të rinjve dhe jo Paulin Sterkajve dhe një grushti tjetër kriminelësh që i bëjnë duanë Edi Ramës nga mëngjesi deri në darkë", - tha Basha në Shkodër.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Shkodër

MALLTEZI: RAMA, ÇOJE GJUSHIN NË BURG

Jamarbër Mallezi, anëtarë i kryesisë së PD-së postoi dje disa fotografi të ndërtimeve në Durrës e rrethina, duke akuzuar se të tilla ndërtime në rrethë janë "Made in Gjushi". Mallezi në denoncimin e tij shprehet se vetëm Gjushi mund të bëjë të tilla ndërtime si prej "prestigjatori". Ai e quan Vangjush Dakon, "prestigjator" të Edi Ramës. Mallezi përmend edhe Elvis Roshin, Gent Dajën dhe emra të tjera si të përfshirë në afëra ndërtimesh në rreth, ndërsa thekson se nëse Rama është ambientalist i vërtetë, të çojë Dakon dhe të tjerët në burg.

Kryemadhi: LSI do të dyfishojë buxhetin për arsimin

Kryetarja e LSI, Moni ka Kryemadhi, takoi dje një grup gjimnazistësh nga dy shkolla në Tiranë, duke theksuar se dëshitimi më i madh i qeverisë është lënia e rinisë pas dore. Ajo tha se largimi i tyre është plaga më e madhe që politika i ka shkaktuar Shqipërisë. "Sot (dje) u takova me një grup gjimnazistësh nga shkollat 'Qemal Stafa' dhe 'Sinan Tafaj'. E jashtëzakonshme, energjia e tyre pozitive dhe dëshira për ta parë Shqipërinë si shtetpinë tonë të përbashkët. Dëshitimi më i madh i kësaj qeverie është lënia e rinisë pas dore.



Largimi i tyre nga vendi, vrasja e shprehës dhe ëndrrave të tyre është plaga më e madhe që politika e mbrapshtë i ka shkaktuar Shqipërisë. Rinia është themeli i programit të LSI. Ne nuk do t'i zhgënjëjmë të rinjtë. LSI do të dyfishojë

buxhetin për arsimin. Një rini e mirë arsimuar dhe punësimi i saj është garancia e vetme për një Shqipëri që nuk plaket! Ne duhet ta bëjmë Shqipërinë shtetpinë për rininë tonë", shprehet zj.Kryemadhi.

ka për të pasur Shqipëri në Europë, nëse nuk largohet kjo bandë hajdutësh. Kemi pasur dy mundësi të rreshtojmë krah bandës dhe tjetra të rreshtojmë krah jush. PD e mori vendimin, dogji mandatet dhe u rreshtua krah jush. Zgjedhje fasadë nuk ka për të pasur më", u shpreh kreu i opozitës.

PREMTIMI

Gjatë takimeve në Malësinë e Madhe, Lulzim Basha

u ndal në një biznes të vogël, teksa sulmoi edhe qeverinë. Kreu i PD premtoi se kur të vijë në pushtet, do të heqë të gjitha taksat që ekzistojnë për biznesin. "Kush bën xhiro deri në 140 milionë lekë, nuk do të ketë asnjë taksë. Do të paguajë vetëm 0.5% të xhiros, por asnjë TVSH. Madje, në çdo dyqan do të vëmë një pullë te dera që ndalon futjen e tatimorëve apo çdo autoriteti tjetër", -

premtoi z.Basha. Kurse gjatë takimeve në Koplik, kreu i PD-së premtoi se do të bëjë gjithçka që të ndalë hemorragjinë e largimeve. "Po ecën shumë keq. Shumë njerëz kanë ikur nga Malësia e Madhe. Gjithçka ndikon te konsumi. Plus që taksat e reja na detyrojnë që çdo ditë të largojmë punëtorët që kemi pasur. Në Koplik janë 3 bukëpjekës dhe të gjithë janë në të njëjtën sit-

PD lajmëron strukturat, të mërkurën seancë dhe protestë

Partia Demokratike do të protestojë sërish të mërkurën, kur zhvillohet edhe seanca parlamentare, ashtu siç në fakt ka paralajmëruar. Të mërkurën pritet të mbahet seanca e radhës plenare, edhe pse nuk ka ende një njoftim zyrtar nga Kuvendi. Burimet brenda PD-së bëjnë me dije se opozita do të protestojë sërish para Kuvendit. Skenari i shqërrimit të çdo seance parlamentare me protesta para Kuvendit po përsëritet nga opozita prej rreth 1 muaji e gjysmë, që kur ka nisur aksioni opozitar. Degët e Tiranës dhe disa qytete përreth janë njoftuar që të jenë në gatishmëri për protestën. Ndërkaq, nga lista shumëmbrore e kandidatëve të PD për zgjedhjet e 2017 vijon aplikimi për deputetë. Kështu, Halil Jakimi, kandidat i PD-së në qarkun Dibër dorëzoi dje në KQZ formularin e dekriminalizimit. Një tjetër kandidat në listat për deputet në PD ka dorëzuar formularin e dekriminalizimit. Jakimi është kandidat për deputet në listën e PD, në qarkun Dibër. Kujtojmë që në Kuvend, pas dorëzimit të mandateve të opozitës dhe zëvendësimit me kandidatët e tjerë plotësues të listës pasuese, ndodhen rreth 98 deputetë.

uat", u shpreh bukëpjekësi. "Ne duhet të ndalim hemorragjinë e largimeve. Para një muaji e gjysmë ishim në Hot dhe atje ishte mbyllur shkolla krejt. Prindërit qanin dhe nuk bëhet fjalë për një vend të varfër. Vendi ynë i ka të gjitha mundësitë të mbajë popullsinë aktuale, por edhe ta dyfishojë, prandaj prioritet është kthimi i rritjes ekonomike, i cili hap edhe

vende pune. Kjo do të jetë një nga sfidat tona kryesore. Do kemi mbështetjen tonë totale. Taksa e vetme që do paguani me qeverinë e Partisë Demokratike do të jetë 0,5% e xhiros, taksë e përbashkët vendore dhe qendrore. Kështu që ju s'do ta kenim mendjen tek rryshfeti që kërkon shteti, por do ta kenim mendjen vetëm të punoni e të prosperoni", deklaroi z.Basha.



Ambasada e SHBA: Shqipëria një aleate e fortë, mund të mbështetet tek Amerika

BE, Soreca: Të bashkohen të gjithë për integrimin e vendit

"Ka ende sfida në fushën e sundimit të ligjit"

Valentina Madani

Në 10-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ambasada amerikane shpërndau dje një mesazh për vendin tonë. Ambasada kujton fjalët e ish-presidentit amerikan, George W. Bush në vizitën e tij në Shqipëri, ndërsa siguron se Shqipëria mund të mbështetet tek Shtetet e Bashkuara ashtu si Shtetet e Bashkuara mund të mbështeten tek Shqipëria. "Shqipëria është një mike e besuar dhe një aleate e fortë. Shpresoj se vizita e sotme do të dërgojë te populli shqiptar mesazhin se ju mund të mbështeteni tek Amerika, ashtu si Amerika mund të mbështetet tek ju, për të punuar fort për të përhapur lirinë dhe, si rrjedhojë, paqen", tha ish-Presidenti i Shteteve të Bashkuara George W. Bush gjatë vizitës së tij historike në Tiranë në 2007, teksa Shqipëria përgatitej të hynte në NATO. Ndërsa Shqipëria feston 10-vjetorin e anëtarësimit në NATO, ushtarët amerikanë marshuan me krenari përkrah Forcave të Armatosura të Shqipërisë, duke i qëndruar këtij premtimi. Edhe sot, Shqipëria mund të mbështetet tek Shtetet e Bashkuara, ashtu si Shtetet e Bashkuara mund të mbështeten tek Shqipëria. Gëzuar përvjetorin e 10-të, Shqipëri!", thuhet në mesazhin e ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.



Ambasadori i Bashkimit Europian në Tiranë Luigi Soreca

DEKLARATA

"Ende ka shumë sfida, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. Tani është koha që të gjitha institucionet shtetërore, partitë politike, shoqëria civile, sektori privat, të gjithë njerëzit të punojnë së bashku për të çuar më tej vendin, edhe në pikëpamjen e vendimit që do të merret në qershor", - tha z. Soreca.



Bushati: Në Shqipëri asnjë parti kundër anëtarësimit në BE

Ish-ministri i Jashtëm Dittmir Bushati kujtoi dje 10-vjetorin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Shqipërisë dhe BE-së. Bushati nënvizon se Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si marrëdhënia më e lartë angazhuese ndërmjet Shqipërisë dhe BE, parasheh një afat 10-vjeçar indikativ, të ndarë në dy faza 5+5, për të përgatitur gradualisht anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian. "Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si marrëdhënia më e lartë angazhuese ndërmjet Shqipërisë dhe BE, parasheh një afat 10-vjeçar indikativ, të ndarë në dy faza 5+5, për të përgatitur gradualisht anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian. Që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, kemi hedhur hapa të rëndësishëm përpara, me marrjen e statusit të vendit kandidat, marrjen e rekomandimit të qartë të Komisionit Europian për nisjen e bisedimeve për anëtarësimin dhe vendimmarrjen e BE-së për nisjen e procesit "screening" dhe kalendarin e bisedimeve. Edhe pse progresi gjatë kësaj deкаде është i pamohueshëm, mbetemi larg objektivit të përcaktuar në marrëveshje", -shprehët z.Bushati. Sipas tij "Në Shqipëri, në dallim prej shumë vendeve të tjera, nuk ka asnjë forcë politike që të kundërshtojë procesin e anëtarësimit të vendit në BE. Mirëpo kjo nuk mjafton. Politika ditore ka triumfuar shpesh mbi interesin kombëtar, duke injoruar një fakt kokëfortë: nevojën jetësore të shoqërisë për të qenë pjesë e vlerave dhe standardeve europiane".

"Dialog duhet bërë nëpërmjet BE-së"

CDU, Staffler: Pakënaqësia artikulohet përmes protestave

Një nga personat që do të shprehë afërsisht në BE këtë të tutje do të jetë Katrin Staffler, deputete e CSU-së, e cila prej fillimit është raportuesja e re e CDU/CSU-së në Komisionin e BE-së së Bundestagut. Në intervistë me DW-në, ajo shpreh se Gjermania nuk duhet të ndërhyjë në politikën e brendshme të Shqipërisë, çdo dialog duhet të kalohet nga BE. "Mendoj se qeveria gjermane nuk ka pse të ndërhyjë në konfliktin si e tillë. Ne jemi të përfshirë në BE dhe mendoj se çdo dialog duhet bërë në radhë të parë nëpërmjet Bashkimit Evropian", tha zj. Staffler. Ajo foli për një situatë të vështirë në Shqipëri teksa tha se: "Qytetarët janë të pakënaqur dhe këtë e artikulojmë me anë të protestave. Ky është kuptimi që ka demokracia. Sigurisht, është një situatë e vështirë, sepse zgjedhjet e ardhshme janë në vitin 2021. Kjo nuk do të thotë që Parlamenti ose Presidenti të mos hapin rrugën



Katrin Staffler, deputete e CSU-së

REAGIMI

"Qytetarët janë të pakënaqur dhe këtë e artikulojmë me anë të protestave. Ky është kuptimi që ka demokracia. Sigurisht, është një situatë e vështirë, sepse zgjedhjet e ardhshme janë në vitin 2021", -tha zj. Staffler.

për të krijuar kushtet e duhura për të vazhduar rrugën e reformave. Sepse unë mendoj se reformat kanë ngecur në vend për shkak të situatës së vështirë në të cilën ndodhet vendi. Dhe kjo nuk e ndihmon situatën", -tha Staffler. Ajo për mëtej: "Reforma e drejtësisë është një pikë

shumë e rëndësishme. Vërtet që vetingu ka shënuar një hap përpara, por duhet pritur derisa të përmbillen të gjitha verifikimet. Sepse vendet vakante duhen zënë me personel. Unë shpresoj që aty të punësohen njerëz kompetentë".

shumë sfida, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. Tani është koha që të gjitha institucionet shtetërore, partitë politike, shoqëria civile, sektori privat, të gjithë

njerëzit të punojnë së bashku për të çuar më tej vendin, edhe në pikëpamjen e vendimit që do të merret në qershor", -nënvizoi ambasadori i BE-së në Tiranë.

mendi se donose vendi ka bërë përparim të dukshëm në këto 10 vite, ka ende shumë sfida, duke theksuar veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. "Ende ka

REFORMA AFATI

Në krye të reformës zgjedhore emërohet Damian Gjicknuri

U emërua dy muaj më parë, ikën Gjylameti nga drejtimi i komisionit

Më 31 janar të këtij viti Kuvendi votoi propozimin e kryetarit të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, për zgjedhjen e Blerina Gjylametit në krye të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Sipas vendimit të Kuvendit, Gjylameti zëvendësoi në këtë pozicion Bledi Çuçin, i cili ndërkohë ishte emëruar ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Po me të njëjtin vendim, Kuvendi zgjodhi anëtarë të këtij komisioni, Damian Gjicknuri, i cili ndërkohë ishte lenë i lirë nga preokupimi i tij si ministër. Por, kur kanë kaluar vetëm 2 muaj nga miratimi i këtij vendi-



mi, Partia Socialiste ka ndryshuar sërish mendim dhe ka vendosur që këtë vendim ta zhbëjë. Kështu, grupi par-

lamentar i PS-së ka vendosur sot që t'i propozojë sërish seancës plenare që kryesimin e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore t'ia heqë Blerina Gjylametit dhe t'ia kalojë atë Damian Gjicknuri. Kujtojmë që po kryesia e PS-së një javë më parë e komandoi Gjicknurin si sekretar për çështjet zgjedhore në vend të Bledi Çuçit. Ndaj, emërimi i tij në krye edhe të komisionit është deri diku i logjikshëm, pasi ai është një nga njohësit më të mirë të çështjeve zgjed-

hore në PS. Por, nga ana tjetër nuk dihet ende nëse kemi të bëjmë me një propozim që ka marrë pëlqimin e vetë Gjylametit, por vetëm një javë më parë ajo u përfshi në një debat të ashpër me kryeministrin Edi Rama, të zhvilluar gjatë kongresit të PS-së. Mediat shkruajtën ato ditë edhe për një dorëheqje të Gjylametit nga pozicioni i kryetares së PS-së, lajm që vonë u hodh poshtë prej saj.



Një nga mbledhjet e Grupit të PS-së

Grupi i PS ka propozuar shtyrjen e afatit të reformës zgjedhore me 3 muaj

Komisioni 3 muaj afat, PS "pranon" shtyrjen e zgjedhjeve vendore?

Afati i komisionit mbaron përtej 30 qershorit

Në kulmin e krizës politike dhe në kushtet kur opozita gjendet në rrugë duke kërkuar zgjedhje të parakohshme parlamentare, Partia Socialiste, e cila deklaroi se zgjedhjet vendore do të mbahen në 30 qershor, ka vendosur që të shtyjë me 3 muaj të tjera afatin e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Vendimi është marrë dje gjatë mbledhjes së grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe më pas është konfirmuar në mbledhjen e përgjithshme të kryesisë. Shtyrja bëhet për t'i dhënë mundësi komisionit që të shqyrtojë të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR, por edhe për të krijuar edhe një mundësi tjetër që opozita e re dhe ajo e vjetër të bëhet pjesë e diskutimeve dhe miratimit të draftit final. Por, me këtë vendim duket se PS ka bërë një "autogol", pasi në mënyrë indirekte ka pranuar që zgjedhjet vendore që janë dekretuar për t'u mbajtur në 30 qershor, mund edhe të shtyhen në një kohë tjetër më të përshatshme. Kjo, pasi shtyrja e afatit të komisionit me 3 muaj do të thotë që ky komision të përfundojë veprimtarinë e tij të paktën 1 javë pas zgjedhjeve vendore të 30 qershorit.



Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore

AFATI

Me këtë vendim duket se PS-ja ka bërë një "autogol", pasi në mënyrë indirekte ka pranuar që zgjedhjet vendore, të cilat janë dekretuar për t'u mbajtur në 30 qershor mund edhe të shtyhen në një kohë tjetër më të përshatshme. Kjo, pasi shtyrja e afatit të komisionit me 3 muaj do të thotë që ky komision të përfundojë veprimtarinë e tij të paktën 1 javë pas zgjedhjeve vendore të 30 qershorit.

e tij në praktikë, i bie që zgjedhjet vendore të mund të mbahen vetëm gjatë vjeshtës së ardhshme. Ndaj, nëse PS ka vendosur që të shkojë në zgjedhje me kodin e ri të amenduar, atëherë shtyrja e këtij afati me 3 muaj lë të kupto-

het që socialistët po shkojnë drejt pranimit të shtyrjes së datës së zgjedhjeve vendore në një kohë tjetër. Por, gjithsesi nuk duhet marrë si një konfirmim përfundimtar i shtyrjes së datës së zgjedhjeve vendore, pasi nuk përjashto-

het mundësia që PS të shkojë në zgjedhje edhe me këtë Kod Zgjedhor. Por, shtyrja e afatit të komisionit me 3 muaj nuk është shenja e vetme që tregon se socialistët mund të pranojnë të shtyjnë datën e zgjedhjeve, me qëllim që pjesë e tyre të bëhet edhe opozita. Një tjetër tregues që PS nuk është e sigurt që zgjedhjet do mbahen në 30 qershor ishte edhe vendimi i kësaj force për të mos bërë publikë kandidatët për kryetarë bashkie, veç atyre që ishin konfirmuar publikisht dhe që nuk kishte më asnjë dilemë. Mospublikimi i kandidatëve për të gjitha bashkitë la të kuptohet se PS duke iu trembur shtyrjes së zgjedhjeve vendore, kërkoi të mos i dëgjë kandidaturat e veta para kohe. Një javë më parë, kryeministri Edi Rama në fjalën e tij në Kuvend bëri të ditur se mazhoranca do të miratonte së bashku me opozitën e re ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Madje, ai ftoi edhe opozitën që është larguar nga Kuvendi të bëjë pjesë e diskutimeve, por duke bërë të ditur se ftesa nuk ishte për shumë kohë. Nga ana tjetër, opozita vijon të mos deklarohet nëse do bëhet pjesë e zgjedhjeve vendore pa u dorëhequr më parë kryeministri Edi Rama, por ka theksuar se nuk do të ketë zgjedhje me këtë qeveri.

Braho sulmon Tufën: Ballist, të shkarkohet. Shkrimtari: Ish-sigurims

Miratimi i projektrezolutës për vlerësimin e veprimit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2018 është bërë objekt debatësh në Komisionin i Ligjeve. Në fakt, ndonëse bëhet fjalë për një procedurë rutinë për vlerësimin e veprimtarisë së një institucioni të parëndësishëm, deputetët socialistë kanë kritikuar frymën e raportit vjetor të këtij institucioni, ndërsa kanë akuzuar kryetarin e tij, Agron Tufën, si të njëanshëm. Ka qenë deputeti Spartak Braho, ai që e ka ngritur këtë shqetësim, duke mos nguruar të kërkojë edhe shkarkimin e Tufës. "Ky institut me Agron Tufën në krye është kthyer në një seksion të Partisë së Ballit Kombëtar dhe ka marrë përsipër të nxijë çdo gjë, duke përfshirë luftën, heronjtë, dëshmorët dhe nuk ka asgjë shkencore në tërë analizat që ka bërë ky institut. Ky është një institut studiimi dhe nuk ka pse ngatërohet me politikën, nuk ka pse operon me terminologji lustracioni, sepse lustracioni është i ndaluar me ligjin që kemi miratuar. Ka shumë helm bërta në të gjithë veprimtarinë e këtij instituti. Në këto kushte, unë nuk do ta votoj pozitivisht këtë rezolutë, madje do kërkoj shkarkimin e Agron Tufës deri sa t'i thërras menjëshe dhe të jetë më i ekuilibruar në tërë veprimtarinë e tij", - tha Braho. Ndërkohë që vetë Agron Tufë nisur nga ky debat në Komisionin e Ligjeve ka reaguar nëpërmjet një koment në rrjetet sociale, i cili e quan Brahon ish-sigurims. "Dhuratën më të çmuar sot për ditëlindje ma ka bërë direkt nga salla e Kuvendit, bash përfaqësuesi i zi i ish-Sigurimit të Shtetit, deputeti Spartak Braho. Dëgjojeni dhe, ju lutem, shpërndajeni sa më gjerë ta dinë të gjithë, se si na rrezikohet jeta nga këta neandertalë të komunizmit. Akuzat e Spartak Brahos dhe mllëfi i tij nuk ka asnjë lidhje me institutin. Ne nuk kemi lidhje me asnjë forcë politike. Ne jemi një institut që kemi mbledhur rreth vetes shumë studues", - është shprehur Tufë.



Shoqëria përmbartimore JUSTITIA

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandim, faza e dytë - për shpëlljen e gasarisë së paluashtjes për le çlir të venë hipotekë BKT BANK, më këto të dhëna:
 0 Pasuria "ARE" nr. 17/5, Zona Kadastrale 3339 me sipërfaqe 7780 m² fage 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Daurris, në pronësi të Adrian Sefer Kapllani dit.08.02.1969, zj.Merita Mlyzafer Kapllani dit.24.06.1970
 Në vlerën 8.120.000 (tete milion e njëqind e njëzetë mijë) Lekë.
 0 Pasuria Apartament me sip.120m² nr.pas.41/150-1-1 z.k.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh /13 Durrës në pronësi të Adrian Sefer Kapllani dit.08.02.1969.
 Në vlerën 3.767.299 (tre milion e shtatëqind e gjashtëqindë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.
 Ankandim zhvillohet në datën 11.04.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartuesit gjyqësor me adresë Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.



Nga Nikolin Jaka, Wilson Ahmeti te Mentor Nazarko. Disa nga lista e plotë konsujve

Konsujve të nderit u hiqen targa diplomatike, afati deri 15 prill

Vendimi është bërë i ditur dje nga Gent Cakaj

Ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj, lajmëroi dje një tjetër reformë të rëndësishme, që kërkon t'i rikthejë dinjtetin shërbimit diplomatik dhe institucionit që ai drejton. Vetëm një javë pasi u largua konsulli i Indisë në vendin tonë, i akuzuar për mashtrim, Cakaj ka prezantuar nismën tjetër, atë të heqjes së disa prej privilegjeve që gëzojnë sot konsujt e nderit të shteteve të ndryshme në vendin tonë. Në një deklaratë për mediat, ai tha se nga 46 konsujt nderi që ekzistojnë të regjistruar në Ministrinë e Jashtëm, 38 prej tyre udhëtojnë me targa diplomatike. Një veprim ky, që sipas ministrit në detyrë është në kundërshtim me ligjin. "38 konsujt nderi të Shqipërisë përdorin një automjet me targa kombëtare dhe me një shenjë. Në shkelje të habitshme të këtij ligji janë plot 38 konsujt nderi, të pajisur me targa CD, të cilët hyjnë e dalin në vend si përfaqësues më të lartë diplomatikë", - tha Cakaj.

duhet të paraqesin në Drejtorinë e Protokollit të Shtetit vërtetimin e dorëzimit të targave të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit

KONSUJT

Po kush janë konsujt e nderit të shteteve të huaja në Shqipëri dhe që përfitojnë nga

statusi që kanë. Në faqen e Ministrisë së Jashtëm rezultojnë 45 konsujt nderi, të cilët kryesisht janë emra të njohur publikë dhe që vijnë nga fusha e biznesit. Mund të përmendim këtu emra të njohur publikë si Arben Malaj, Bardhyl Minxhozi, Nikolin Jaka, Agron Papuli, Bujar Lybesha, Esat Ademi, Faik Dizdari, Advin Libohova, Wilson Ahmeti apo Mentor Nazarko. Gjithsesi, duhet theksuar se ashtu siç bën të ditur vetë ministria, jo të gjithë konsujt mbajnë targa diplomatike, pasi nga 45 konsujt nderi të regjistruar, vetëm 38 mbajnë targa diplomatike.



KONSUJT E HUAJ TË NDERIT NË SHQIPËRI

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| 1. Austri | 23. Bullgari |
| ■ Gjergj Leqezja | ■ Selim Hoxhaj |
| 2. Arben Malaj | 24. Sierra Leone |
| ■ Bangladesh | ■ Artan Stroka |
| ■ Shaban Xhabrahimi | 25. Rumani |
| 3. Belgjikë | ■ Elvis Toçi |
| ■ Fabrice Wallaert | 26. Mongoli |
| 4. Bosnje-Hercegovina | ■ Belma Çela |
| ■ Fiqiri Kllari | 27. Portugali |
| 5. Kanada | ■ Dorian Sadiku |
| ■ Krenar Loloçi | 28. Hungari |
| 6. Estonia | ■ Kliti Hoti |
| ■ Sotirag Guga | 29. Letoni |
| 7. Finlandë | ■ Sokol Kraja |
| ■ Bardhyl Minxhozi | 30. Norvegji |
| 8. Islandë | ■ Marinela Jazoj |
| ■ Isuf Berberi | 31. Armeni |
| 9. Indi | ■ Varuzhan Piranjanj |
| ■ Petra Gramo | 32. Pakistan |
| 10. Koreja e Jugut | ■ Seyhan Pencabligil |
| ■ Agron Papuli | 33. Tunizi |
| 11. Malajzi | ■ Nikolin Jaka |
| ■ Gentian Sula | 34. Filipine |
| 12. Marok | ■ Loritan Prespa |
| ■ Bujar Lybesha | 35. El Salvador |
| 13. Qipro | ■ Gerian Kuka |
| ■ Vladimir Avrami | 36. Izrael |
| 14. San Marino | ■ Rodolf Xhillari |
| ■ Esat Ademi | 37. Afrika e Jugut |
| 15. Sllovaki | ■ Zenel Hoxha |
| ■ Faik Dizdari | 38. Sri Lanka |
| 16. Turqi | ■ Mirton Lika |
| ■ Bahadır Aksoy | 39. Indonezi |
| 17. Japoni | ■ Irma Kapllani |
| ■ Avni Ponari | 41. Danimarkë |
| 18. Lituani | ■ Përparim Kalo |
| ■ Kastriot Haska | 42. Francë |
| 19. Slloveni | ■ Ilia Skëndi |
| ■ Edvin Libohova | 43. Ukrainë |
| 20. Kazakistan | ■ Bledi Bajraktari |
| ■ Vilson Ahmeti | 44. Kosovë |
| 21. Itali | ■ Mentor Nazarko |
| ■ Teodor Bilushi | 45. Uruguai |
| 22. Maltë | ■ Ilir Trebicka |
| ■ Tomë Preku | |

Etilda Gjonaj: Kushtetuesja në qershor, amnistia pas zgjedhjeve

Brenda muajit qershor të këtij viti, Gjykata Kushtetuese do të ketë kuorumin e nevojshëm për të marrë vendime. Kështu deklaroi ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, e pranishme në Komisionin e Integrimit në Kuvendin e Shqipërisë, ku diskutoi për ecurinë e reformës në drejtësi dhe luftën ndaj korrupsionit. Gjonaj garantoi emërimin brenda muajit qershor edhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Të pranishëm në komision ishin edhe de-



putetët e rinj të opozitës. Rudina Hajdari u shpreh kritike për punën e Ministrisë së Drejtësisë ndaj luftës kundër korrupsionit dhe mbi të drejtat e njeriut, që lidhen kryesisht me pronat. Gjonaj tha se lufta ndaj korrupsionit ka dhënë rezultate tejet pozitive dhe fale forcës së Task-Forcës janë dhënë 396 masa administrative, 344 masa disiplinore, ndërsa 36 persona janë kallëzuar penalisht. Në përfundim të punimeve të komisionit, Gjonaj iu përgjigj interesit të medias në lidhje me amnistinë. Sipas saj, kjo çështje do të shkojë në parlament dhe nëse gjykohej se ndikon në zgjedhje, amnistia do të bëhet fill pas tyre.

Nga ana e Shoqërisë "Shërbimi Perbarimorë AB" Shpk është shpallur ankandi faza e dytë për pasurinë e mëposhtme:

1-"Apartamenti" me sipërfaqe totale 125 m² me Nr.pasurisë 4/63+1-42 në Zonen Kadastrale 8602. Volumi 16 Fage 109 e ndodhur në Vlorë. Cnimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 38,528 (tridhjetë e tete mijë e pesëqind e njëzet e tete) Euro.

Ankandi do të zhvillohet në datë 19.04.2019 në orën 16:00 pranë zyrës së shoqërisë "Shërbimi Perbarimorë AB" Shpk me Perbarues Gjygesor Privat Admir Beqiri të ndodhur në adresën Rr.Bul Zhan Dark Palli.Kulla.1Tknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane.

UNICEF | for every child | UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF) Albania Country office

INVITATION TO BID

Subject: Sale of UNICEF Office vehicles.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive bids from interested companies/individuals who wish to be considered for the purchase of two UNICEF vehicles.

Please consult UNICEF Albania website at (<https://www.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers>) and UN Albania website at (<http://www.un.org.al/employment-and-procurement>) to get further information on the vehicles, terms and conditions of the bid and to see the photos of the vehicles.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The bids must be delivered, in a sealed envelope, which must be clearly marked: "**BID for Purchase of UNICEF Albania vehicles**" - Name of the entity, - Contact details", to the following address:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania
Tel.: +355 4 454 8400
Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies/individuals must submit their bid, not later than **14:30 hr. Friday, 12 April 2019.**

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, përfituesit që marrin paratë

Pronarëve që u janë zënë tokat nga ndërtime... Prorarëve që u janë zënë tokat nga ndërtime pa leje duhet të paraqiten në Agjencinë e Trajtimit të Pronave...

Pronat, kompensim për 500 pronarë, 2 mië lekë kostoja e aplikimit

Lista me përfituesit, 6 dokumentet që duhet të dorëzohen në Agjenci

se miratuar në VKM për subjektet përfituese... Prorarëve, tokat e të cilëve janë zënë nga ndërtime informale...

PROCEDURAT

Procedura e aplikimit nga subjektet përfituese është e thjeshtë...

paraqitet nga një pjesë e bashkëpronarëve... Kërkesa në VKM nr.383, datë 19.05.2010...

paraqitet nga një pjesë e bashkëpronarëve, ajo shoqërohet nga prokura e posaçme, e nënshkruar prej tyre...

- DOKUMENTET
1. Kërkesa për kompensim sipas formatit tip, e cila plotësohet në ATP.
2. Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët...

KOMPENSIMI PËR 500 PRONARË

Table with 18 columns: EMËR, MBIEMËR, FEJME, HASEQIU, HYSEN, GAJTA, AGIM, PEPA, BEDRI, XHAMETA, ARBEN, CANI, etc. Lists names of individuals and their details.

Bizneset vihen çdo ditë në më shumë në vëshitësi ekonomike për shlyerjen e detyrimeve. Listës së borxhlinjve të këqij në Tatinë janë shtuar edhe 4361 biznese vetëm në tetë muaj. Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nga qershori 2018 deri në fund të shkurtit 2019, lista e zezë e bizneseve borxhlinjëve u zgjerua me 17%, duke arritur në rreth 24.5 mijë. Qarqet me numrin më të madh të borxhlinjëve rishtarë ishin Vlora dhe Tirana. Lista e tatimpaguesve me detyrime të papaguara në afat,

Përkeqësohet klima e biznesit, shtohen 4361 biznese në listën e zezë

përfaqëson bizneset ndaj të cilave Administrata Tatimore, në zbatim të nenit 91 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", ka vendosur marrjen e masave të sigurimit mbi të gjithë pasuritë për ekzekutimin e detyrimeve dhe se ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të tyre. Sipas Tatimeve, lista është publike me qëllimin që personat e tretë

të marrin dijeni për fillimin e këtyre procedurave dhe që organet apo institucionet, të cilat kanë bërë regjistrime të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesve debitorë, të regjistrojnë detyrimin tatimor të papaguar si barrë mbi këtë pasuri dhe të mos lejojnë kryerjen e transaksioneve për transferimin e pasurive të tatimpaguesve debitorë deri në momentin që detyrimi tati-

mor i papaguar të arkëtohet. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, nëpërmjet një urdhri me shkrim, të lëshuar nga drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, i kërkon çdo banke, ku tatimpaguesi ka llogari në emër të vet, të bllokojë shumat për llogari të tatimeve. Sipas të dhënave zyrtare nga Tatimet, gjendja e detyrimeve të papaguara, të cilat ndiqen



deri më 31 dhjetor 2017, rezultoi 95.5 mld lekë, ose 35% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Në stokun e borxhit të ndarë sipas llojit të tatimit, TVSH zë

peshën më të madhe me 36%, e ndjekur nga Tatim Ftitimi me 28%, zëri Tjera me 22%, Sigurimet Shogërore & Shëndetësore me 12% dhe TAP me 2%.

Vendimet gjyqësore, qeveria akumulon 1.9 miliardë lekë detyrime në vitin 2018

Detyrimet e prapambetura, fatura 6.2 miliardë lekë

Nuk janë shlyer punët publike, infrastruktura 2.7 miliardë lekë borxhe

Vendimet gjyqësore, punët publike, rim bursimi i TVSH-së janë tre prej zërave me peshën më të madhe të borxhit të pa shlyer nga qeveria. Ministria e Financave ka publikuar shifrat për vitin 2018, ku rezultoi se fatura e detyrimeve të akumuluarra në total është rreth 6.2 miliardë lekë. Peshën më të madhe të detyrimeve e zënë ato për vepra infrastrukturore apo borxhet e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, në rreth 2.7 miliardë lekë. Një zë tjetër shqetësues është fatura që qeveria paguan për vendime gjyqësore për pushimet nga puna, e cila për vitin 2018 rrumbullakohet në 1.9 miliardë lekë. Ndërkaq, përpos stokut total të mosrimbursimit të TVSH-së, rreth 105 milionë lekë është vlera për vendime gjyqësore që janë fituar nga subjektet në rastet kur ka pasur faturime të gabuara nga ana e punonjësve. Për periudhën janar 2016-dhjetor 2017, detyrimet e prapambetura regjistroheshin në 5.7 mld lekë.

RAPORTI

Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, mësohet se Ministria Infrastrukturas dhe Energjisë raporton që detyrimet e krijuara për periudhën tetor-dhjetor 2018 janë në vlerën 648.3 milionë lekë si 3-mujor ose 3.24 miliard lekë progresiv deri në dhjetor 2018, kryesisht referuar detyrimeve të ARRSH-së dhe AKUK-së për: Mirëmbajtje rrugore - 67.2 milionë lekë, ndërtim dhe sistemim rruge 45.3 milionë lekë, vendime gjyqësore 701.8 milionë lekë, detyrime të ndërmarrjeve Ujësjellës-Kanalizime 455.3 milionë lekë. Ndërkohë, nga stoku i shtatorit 2018 MEI ka trashëguar rreth 2.59 miliardë lekë detyrime. Ministria e Mbrojtjes raporton 988.9 milionë lekë detyrime të akumuluarra, ku pjesa më e madhe i përket programit të Emergjencave Civile. Për tremujorin tetor-dhjetor 2018, ky institucion ka krijuar detyrime të reja në vlerën 101.5 milionë lekë, ndërkohë që stoku i mbar-



Ministria e Financave

tur është rreth 887.4 milionë lekë. Në të njëjtën periudhë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë raporton që detyrimet e krijuara vlerën 2 milionë lekë dhe në total MASR ka 57.8 milionë lekë detyrime të akumuluarra. Ministria e Drejtësisë raporton një total të detyrimeve të prapambetura për deri në dhjetor 2018 (progresiv) raportohet në vlerën 77 milionë lekëve. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një stok detyrimesh të prapambetura prej 377 milionë lekë. Ky institucion ka krijuar detyrime të reja në vlerën 68.9 milionë lekë, kurse ato të mbartura nga vlerësimi më i fundit i muajit shtator 2018 janë rreth 308.1 milionë lekë. Ministria e Brendshme ka krijuar një stok i detyrimeve deri në dhjetor 2018 është në vlerën 735.7 milionë lekë. Detyrimet e reja të krijuara në periudhën tetor-dhjetor 2018

janë në vlerën 41.1 milionë lekë, ndërkohë që stoku i mbartur është 694.5 milionë lekë dhe konkretisht: 284.6 milionë lekë detyrime për vendime gjyqësore të mbartura për ish-punonjës të larguar, IKMT; 260 milionë lekë detyrime të reja të Gjendjes Civile për shpërbllimin e munguar të lindjeve dhe 150 milionë lekë detyrime për mbikohë pune, uniforma dhe shpenzime udhëtimi dhe shpenzime parkimi. Ndërkohë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka krijuar detyrime për periudhën tetor-dhjetor 2018, por në total ka të akumuluarra 38.9 milionë lekë, ku 17.4 milionë u dedikohen detyrimeve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Edhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka detyrime të prapambetura të krijuara rishtazi, por deri në dhjetor 2018 ka një stok detyrimesh në masën 11.3

milionë lekë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë për tremujorin tetor-dhjetor 2018 nuk ka krijuar detyrime të reja të prapambetura. Në total stoku i detyrimeve të akumuluar deri në dhjetor 2018 është 340.4 milionë lekë, ku 273.2 i dedikohen detyrimeve për vendime gjyqësore. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar një stok detyrimesh deri në dhjetor 2018 në vlerën 203.2 milionë lekë. Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve në total deri në dhjetor 2018 ka akumuluar 105.2 milionë lekë detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore lidhur me rimbursimin e TVSH-së. Gjatë 3-mujorit tetor-dhjetor 2018 DPT nuk ka krijuar detyrime të reja.

Rrethrotullimi i Kamzës,

ARRSH: Punimet zgjasin dy muaj

Duke nisur nga data 3 prill do të nisnin punimet për ndërtimin e rrethrotullimit të Kamzës në segmentin rrugor kryqëzimi Universiteti Bujqësor-kryqëzimi Kamëz qendër, km 1+100". Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se për shkak të kryerjes së punimeve, qarkullimi i mjeteve do të bëhet me shpejtësi të reduktuar dhe do të kryhet në përputhje me sinjalistikë e vendosur sipas Planit të Menaxhimit të Trafikut të miratuar. Punimet do të zgjasin deri më datë 3 qershor 2019. "Punonjësit e ARRSH-së, Policisë së Qarkullimit Rrugor dhe kompanisë së mirëmbajtjes do të jenë në terren për mbarëvajtjen e ndërhyrjes dhe orientimin e trafikut. Nga ARRSH dhe Policia e Qarkullimit Rrugor kërkohet mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i drejtësve të mjeteve dhe bizneseve të zonës gjatë procesit të ndërhyrjes në këtë segment rrugor, respektimi në mënyrë rigorozë i sinjalistikës provizore të vendosur, si dhe ndjekja e udhëzimeve të Policisë Rrugore në terren", thuhet ndër të tjera në njoftimin e ARRSH-së.

ISLAMIC RELIEF

WORLDWIDE

Rr. "Durrësit" Laprakë E Re Blloku Gintash, Pall. E, Ap 8, Tirana, Albania
Tel: (+355) 424 13 190
E-mail: info@islamicrelief.al

Ftesë për Tender

Fondacioni Islamic Relief- Albania Office ka hapur ftesën për ofertë me objekt:

"Blerje Mishi per Projektin e Kurban Bajramit 2018"

Informacion i përgjithshëm:

1. Të gjitha bagetët duhet të jetë të përshtatshme për të përbushur kriteret e kurbanit.
2. I gjithë mishi duhet të jetë 100 % hallall.

Kerohet nga kompania e interesuar për këte bashkëpunim që të perleshje shtetshëm:

1. Sigurimi Produktit të Mishit,
2. Të siguroj thertore, me të gjitha standartet higjieno-sanitare dhe kapacitet e nevojshme,
3. Të siguroj transportin me makina frigoriferike,
4. Të kryej paketimin e pakove të mishit (1 pako përmban 4 kg mish),
5. Të ofroj fature tatimore.

Oferta kerohet për:

Dele - 245 cope (Type: Dele (mashkull), Peshë: Minimumi 45 Kg dhe Max 55 Kg (peshë e gjalle) mesatarja 27 KG mish neto pasi është therrur (Duke hequr kokën, këmbët dhe të brendshmet e kalshtës). Moshë: 1 - 2 ½ Vjeç)
Vica - 35 cope (Type: Vjeç, Peshë: Minimum 180 Kg (peshë e gjalle) mesatarja 99 KG mish neto pasi është therrur (Duke hequr kokën, këmbët dhe të brendshmet e bagetisë). Moshë: 2 - 4 ½ Vjeç
Oferta juaj duhet të jetë në një zarf të mbyllur dhe të vlosurur dhe duhet dërguar në adresën:
Adresa: Laprakë, rruga e Durrësit, Blloku Gintash, pall E, kati II, ap 8, Tirana ose mund ta dërgoni në posten elektronike: info@islamicrelief.al

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është më datën **07.08.2018**.

Për çdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni në: info@islamicrelief.al ose të kontaktoni ne: Tel. : +355 42413190, Cel. : +355 67 34 5330

VRASJET NE SHKODER DEBATET

Kryebashkiakja Voltana Ademi: E keni gabim, sapo ka filluar, ndihem e frikësuar

Lleshaj nga Shkodra: Kemi pasur goditje të forta në drejtim të sigurisë publike

"Krimi s'është i atyre përmasave sa t'na shkaktojë frikë"

SHKODËR

Tri ditë pas ekzekutimit në një atentat mafioz të vëllezërve Astrit dhe Ibrahim Bilali, ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, u rikthye sërish në Shkodër këtë herë për të prezantuar prefektin e ri, Valdirin Pjetri. Ai foli me shqetësim për situatën e krimit në qytetin verior; që sipas tij është e trashëguar ndër vite. Në takimin ku ishin të pranishëm edhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, kryetari e Bashkisë Shkodër, Voltana Ademi, si dhe drejtori i ri i policisë së qarkut ka pasur debate. Kryebashkiakja Ademi është ankuar për situatën problematike dhe ka kërkuar marrjen e përgjegjësi me seriozitet nga shteti e policia për trajtimin e saj. Nderkaq, ajo është shprehur publikisht para ministrit Lleshaj dhe drejtuesve të policisë se ndihet e frikësuar nga bandat e krimit. Ajo tha se, "detyra jonë është që të mos i lëmë të hanë kokat e tyre", duke përdorur një shprehje të kryeministrit Edi Rama, përkundrazi sipas saj, duhet të bëjmë të mundur që t'i ndalojmë dhe të parandalojmë me sa fuqi që kemi. Ademi theksoi se rikthimi i sigurisë në Shkodër nuk është çështja e vullnetit të një personi dhe se do duhet të ketë forca të specializuara. "Në këto histori - deklaroi ajo - ka pasur edhe njerëz të pafajshëm që kanë ngrënë plumbin". Gjatë fjalës së tij, ministri i Brendshëm ka vlerësuar komunikimin e sinqertë të kryetares së bashkisë, ndërsa ka pohuar se "krimi nuk është në ato nivele sa të shkaktojë frikë dhe se së bashku ashkë do i kthejmë dinjitetin Shkodrës". Më pas, Sandër Lleshaj është larguar duke e lënë kryebashkiakën Ademi duke folur. Ndërsa, kreu i Policisë së Shtetit e ka dëgjuar edhe për pak, por edhe ai ka ikur pa e mbaruar ajo fjalën.

DEBATET NË TAKIM SANDËR LLESHAJ
"Jemi të gjithë të informuar që niveli i sigurisë në qarkun e Shkodrës është sfiduar disa herë gjatë viteve të shkuara, kemi pasur goditje të forta dhe të rënda në drejtim të sigurisë publike, që janë produkt i një krimi të



Takimi i djeshëm në Shkodër



organizuar dhe të përkundër vite, i cili ka arritur të lëshojë rrënjë në qytetin e Shkodrës, i cili në fakt njihet për kryeqytetarinë e Shqipërisë. Ky qytet që i ka dhënë Shqipërisë pjesë të madhe të vlerave, për fat të keq është goditur nga krimi i akumuluar për disa dekada. Me gjithë sukseset e mëdha, goditjet e mëdha që janë dhënë ende mbetet sfidë e madhe. Besoj që drejtori i ri i policisë bashkë me stafin e tij aktual dhe me përfortimet e reja që do të marrë pa asnjë kursim dhe pa asnjë hezitim nga Ministria e Brendshme do jetë në gjendje ta thellojë punën e bërë deri tani për të garantuar që siguria në qarkun e Shkodrës do të jetë në nivelin që meriton.

U bëj thirrje qytetarëve të bëhen palë me policinë përballë krimit dhe përballë atyre që e cenojnë qetësinë dhe jetën normale të tyre.


Shpresoj dhe besoj që prefekti i ri, duke pasur bashkëpunimin e drejtuesve të njësive vendore, besoj do jetë një vlerë e shtuar në përpjekjen e qeverisë për ta përmirësuar jetën e qytetarëve të Shkodrës. Ju lus që vetëm t'i mbështesni, se pak mbështetje, qoftë edhe morale është inkurajim i madh që këta njerëz ta ndiejnë veten në shtëpinë e tyre, të punojnë fort dhe t'u japin qytetarëve siguri".

VOLTANA ADEMI: "Situatat, në të cilën prefekti i ri emërohet nuk është aspak e mirë. Në kemi ndoshta që nga viti 2018 që kalojmë situatë të vështirë. Fakti është që nuk është vetëm Shkodra, është fatkeqësi për qytetin tonë, jemi në prag të sezonit të turistik. Ne duhet ta mbrojmë e ta promovojmë si qyteti ku ndodhin vrasje e grabitje. Po flas si qytetare, si grua, si nënë e si kryetare e Bashkisë së Shkodrës.

FRIKA E KRYEBASHKIAKES

Kryebashkiakja Ademi është ankuar për situatën problematike dhe ka kërkuar marrjen e përgjegjësi me seriozitet nga shteti e policia për trajtimin e saj. Nderkaq, ajo është shprehur publikisht para ministrit Lleshaj dhe drejtuesve të policisë, se ndihet e frikësuar nga bandat e krimit. Ajo tha se detyra jonë është që të mos i lëmë të hanë kokat e tyre, duke përdorur një shprehje të kryeministrit Edi Rama, përkundrazi sipas saj, duhet të bëjmë të mundur që t'i ndalojmë dhe të parandalojmë me sa fuqi që kemi.

Qytetarët e Shkodrës janë njerëz shumë të mirë e duan të jetojnë në vendin e vet. Të gjithë kemi marrë disa përgjegjësi dhe duhet t'i çojmë deri në fund. Kjo punë duhet marrë me seriozitetin që i takon. Fakti që kemi disa vrasje, dy të zhdukur e me radhë, asnjë e zbuluar deri tani. Nuk janë bërë veprime për t'i parandaluar dhe ky është shqetësimi ynë ndoshta më i madh. Ju duhet të bëni diçka që t'i parandalojmë. Detyra jonë është që të mos i lëmë të hanë kokat e tyre, përkundrazi duhet të bëjmë të mundur që t'i ndalojmë dhe të parandalojmë me sa fuqi që kemi. Policia duhet ta gjejë mënyrën, forcat e specializuara duhet ta gjejnë mënyrë dhe ta bëjmë të mundur. Me ndryshimin e drejtuesve, nuk kam pasur respekt për drejtuesit e policisë, në nivelin vendor ata janë përballur me problematike të mëdha. Por, edhe policia nuk mund ta bëjë e vetme, duhet të punojë struktura e gjithë, duhet të ketë mekanizma të specializuara. Larja e hesapeve nuk mund të jetë në rënie të lirë në Shkodër, ne duhet të bëjmë diçka. Nuk e kam parë seriozitetin dhe marrjen e përgjegjësi. Ne duhet të bëjmë diçka që të ketë një stop. Ne kemi një ritëm të



Vendi ku ndodhi atentati ndaj biznesmenit Lulzim Kulla, në janar të 2018-es

lartë emigracioni, të paimagjinueshëm, rritje të mbyljes së bizneseve, rënie të turistëve.

Këto na shqetësojnë shumë, janë përtej të qenit PD, PS e parti të tjera. Ne kemi një situatë problematike në Shkodër e duhet të bëjmë diçka. Unë nuk e di se çfarë, nuk jam specialiste, por kam detyrë ta them me zërin e lartë se frika është e madhe. Bandat kriminale janë larje hesapësh e me radhë. Shteti ka në dorë dhe duhet të marrë përgjegjësinë ta ndalojë. Kjo do të thotë që krimi merr zemër. Po shkojmë drejt një pasigurie absolute, gjë që është frikshme për të gjithë qytetarët. Po flas me zemër, ofroj të gjithë bashkëpunimin. Ne kemi trupë policore të specializuara, janë përpjekur të punojnë, por duhen gjetur mënyra efektive. Ju uroj suksese prefektit dhe drejtorit të ri të policisë do ta kenë bashkëpunimin! Forcat e policisë, drejtuesit e policisë përveç Albana Çelës kanë pasur vullnetin e mirë të bashkëpunojnë. Kjo as që diskutohet në Shkodër. Nuk është çështja e vullnetit të një personi, nuk është aspak politike, nuk e bën as tre veta dhe një polici vetëm në Shkodër, do duhet të ketë forca të specializuara. Ne duhet të parandalonim ngjarjen. Në këto histori ka pasur edhe njerëz të pafajshëm që kanë ngrënë plumbin. Forcat e policisë duhet të jenë të përgjegjshme.

SANDËR LLESHAJ: Ndjej që është komunikim i sinqertë ky dhe e vlerësoj. Përsa kohë ka frikë nuk ka siguri dhe nuk ka rëndësi se si jemi me shifrat. Do të vazhdojmë me ndërhyrje të forta në Shkodër, rreth 20% të vrasjeve në nivel kombëtar i prodhon vetëm Shkodra. Ky është një paradoks i paprurueshëm. Me Shkodrën kam shumë lidhje personale, kur vij këtu, nuk kam nevojë për hotel, të cilat më bëjnë trefsh të angazhuar që të bëj maksimumin për këtë qytet. Du-

het të bëhemi bashkë përballë krimit. Krimi nuk është i atyre përmasave sa të na shkaktojë frikë. Nuk është aq i madh krimi sa t'na bëjë të kemi frikë

VOLTANA ADEMI: E keni gabim, sapo ka filluar.

SANDËR LLESHAJ: Duhet të mobilizojmë gjithë shoqërimin për të luftuar krimin. Nuk ka asnjë hapësirë për të pasur frikë nga krimi. Ne do t'i fuqizojmë kapacitetet tona të policisë në Shkodër. Jo më kot kam ftuar edhe drejtuesit e Kukësit dhe Lezhës, do të mobilizojmë burime nga këto drejtori në Shkodër, që edhe në perceptim të ketë ndryshim. Nuk duhet të ndiejmë frikë. Nëse ndjen frikë kryetari e bashkisë, kemi një problem të madh.

VOLTANA ADEMI: Fola në gjetur të parë, kur fillon tek unë...

SANDËR LLESHAJ: Ky qytet duhet të marrë dinjitetin e tij, ne jemi të angazhuar maksimalisht në këtë.


VOLTANA ADEMI: Nuk është çështje e vullnetit të një personi, nuk është aspak politike. Nuk e bën edhe një polici vetëm në Shkodër, do duhet të ketë forca të specializuara, ne duhet të parandalonim ngjarjen. Në këto histori ka pasur edhe njerëz të pafajshëm që kanë ngrënë plumbin.

ARDI VELIU: Para një jave nuk më kam politikën. Unë jam politikian. Unë jam drejtori i përgjithshëm i policisë. Para një jave nuk më thekë opinionin. Në qoftë se situata ndryshon për një javë... (ikën)

VOLTANA ADEMI: Ju s'mund të largoheni kështu, s'është korrekte me qenë kështu, nëse nuk e shqetëson qeverinë, për mua s'ka problem.

GAZETARI: Kryetare, keni qenë nën presion ose kërcënime?

VOLTANA ADEMI: Është i gjithë pushteti nën presion. Unë deklarata e mia i bëj publike gjithmonë.



VRASJET NË SHKODËR, SHKARKOHET SHEFI I KOMISARIATIT

Vrasja e dyfishtë që tronditi Shkodrën ditën e shtunë ka sjellë edhe shkarkimin e shefit të komisariatit, pas drejtorit të policisë. Lorenc Meta do të zëvendësojë në detyrë Vasil Çelën. Shkarkimi i drejtorit të policisë u bë nga vetë ministri Lleshaj.



Vrasja të shtunën në Shkodër e dy vëllezërve Astrit dhe Ibrahim Bilali ka rikthyer vëmendjen tek grupet kriminale, që prej vitesh veprojnë në këtë qytet. Ibrahim Bilali, 61-vjeçar, ishte drejtues i shoqatës "2 Prilli 1992", ndërsa vëllai i tij, Astriti 59-vjeçar, ishte kampion i garave të hipizmit. Policia njoftoi se, "shërbimet e policisë kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe janë vënë në ndjekje të autorëve të cilët, pas ngjarjes janë larguar me një automjet, i cili është gjetur duke u djegur në një rrugicë, në brendësi të lagjes ku ka ndodhur ngjarja". Ndërsa ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, i cili mbërriti në Shkodër pak orë pas ngjarjes, në përfundim të një analize thau se katërorëshe me ekspertët e policisë vendore dhe atyre të ardhur nga Tirana, deklaroi se "tentakulat e krimit të organizuar kanë arritur përsëri të godasin" dhe se pista kryesore që po ndiqet nga policia për zbardhjen e vrasjeve është "ajo e larjes së hesapeve".

Dyshimet e para të policisë lidhen me hakmarrjen dhe përplasjen mes grupeve kriminale si dhe aktivitetin e djalit të Astrit Bilalit, Asmirit, një ish-kampion i sportit të boksit, i arrestuar në shtator të vitit të kaluar si pjesë e grupit kriminal "Bajri". Rreth një vit më parë, ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, pati deklaruar se në Shkodër veprojnë 4 grupe kriminale, por pa identifikuar asnjërin prej këtyre grupeve. Në të vërtetë, grupet kriminale që veprojnë në Shkodër kanë një histori më shumë se 25-vjeçare, mbushur me vrasje, kërcënime, trafik droge, prostitucion, rrëmbim të pronave etj. Gjatë viteve, disa prej grupeve u larguan nga skena pas vrasjes së drejtuesve të tyre. Mbijetuan grupet më të fuqishme, ato që ishin organizuar në bazë familjeje. Vepërtaria dhe mbijetesja e tyre deri më sot i dedikohet

Policia s'arriti të parandalojë asnjë prej këtyre ngjarjeve të rënda kriminale

Ekzekutimet e frikshme muajt e fundit, VOA: Shkodra, qytet i tronditur nga krimi

"Qetësia mes grupeve u përmbys në 13 janarin e 2018-ës, pas atentatit ndaj biznesmenit Lulzim Kulla"



Vëllezërit e vrarë në atentat
Brahim e Astrit Bilali

mosndërhyrjes në territoret dhe veprimtarinë e njëri-tjetrit dhe aftësisë për të mbështetur grupimet politike, herë të majta e herë të djathta, sipas rotacionit në qeverisje. Por, qetësia mes grupeve u përmbys në 13 janarin e vitit të kaluar pas një atentati me lëndë shpërthyes të telekomanduar ndaj biznesmenit Lulzim Kulla. Sipas policisë, ai ishte një figurë e njohur e krimit në Shkodër. Në këtë atentat, të kryer fare pranë tregut më popullor të qytetit, mbetën të plagosur 8 persona, mes të cilëve edhe vetë Kulla. Ngjarja u pasua nga atentate të njëpasnjëshme ku, deri tani kanë mbetur të vrarë 9 persona, ndërsa dy të tjerë figurorë në zhdukur.

13 janar 2018, atentat kundër biznesmenit Lulzim Kulla në afërsi të tregut pop-

ullor të qytetit të Shkodrës. Qershor 2018, zhduken pa gjurmë Gëzim Hysa dhe nipit i tij Agron Molla.

18 qershor, ekzekutohet me armë Mehdi Kavaja, pronar i një servisi.

15 korrik, vriten në një atentat, në hyrje të banesës, ish-policit Boran Bercana dhe Silvi Ndoci, bashkëjetues me të.

8 gusht 2018, vritet Fatbardh Lici, kumati i Lulzim Kullës dhe vëllai i Mustafë Licit. Ky i fundit këshilltar bashkiak dhe drejtues i një partie politike me shtrirje lokale.

1 shtator 2018, vritet biznesmeni Arjan Ferracaku teksa po kalëronte bashkë me Asmir Bilalin. Dyshohet se autorët e atentatit ngatëruan shënjestrën.

14 nëntor 2018, në tregun popullor të "Rusit" vritet Fa-

tos Ferracaku, kushëri i Arjan Ferracakut.

20 mars 2019, në fshatin Grudë vritet Nard Polia, pronar i një bujtine në Theth, pjesëtar i administratës së Zonave të Mbrojtura.

30 mars 2019, vriten në derën e shtëpisë së tyre vëllezërit Bilal.

Policia nuk ka arritur të parandalojë asnjë prej këtyre ngjarjeve të rënda kriminale, që kanë tronditur banorët e Shkodrës dhe që kanë pasur jehonë brenda dhe jashtë vendit. Vrasja e biznesmenit Arjan Ferracaku, në fillim të muajit shtator të vitit të kaluar dhe tronditja e sigurisë në Shkodër ishin arsytet që opozita e bashkuar bojkotoi seancën plenare të sesionit të ri parlamentar. Përfaqësuesit e opozitës u mblodhën në Shkodër duke denoncuar situatën krimi-

nale në këtë qytet dhe duke akuzuar qeverinë si të lidhur me krimin. Duket se ky tensionim i situatës politike në vend i dha shtysë policisë që të nisë me shpejtësi operacionin "Oazi" për shkatërrimin e njërit prej grupeve më të fuqishme, grupit "Bajri". Operacioni policor, një ndër më të mëdhenjtë e zhvilluar vitet e fundit në Shqipëri, u shtri në Shkodër, Tiranë, Spanjë dhe Rotterdam të Holandës, duke çuar në arrestimin e 12 anëtarëve të këtij grupi, përfshirë edhe drejtuesit e tij. Kjo duket se qetësoi për disa muaj situatën e rendit në qytetin e Shkodrës, derisa në mëngjesin e të shtunës, 30 mars 2019, u vrarë dy vëllezërit Bilali, ngjarje kjo që risolli në vëmendje deklaratën e ish-ministrit Xhafaj se në Shkodër vepron jo një, por katër grupe kriminale.

Ndryshe nga sa pritej, operacioni policor i koduar "Oazi" nuk u dha fund vrasjeve dhe as hakmarrjes mes grupeve kriminale të Shkodrës. Këtë e pranoi edhe vetë ministri Lleshaj në ditën e vrasjes së vëllezërve Bilali kur tha se, "me gjithë goditjet që i janë dhënë krimit në Shkodër, prapë rezultoi që lufta ndaj këtij krimi nuk është fituar ende. Metastazat e këtij krimi treguan se janë gjallë dhe kanë mundësi të godasin".



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,660,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 24 Prill 2019, ora 14:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje një pajisje UPS për nevojat e një 'Server Room' të Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,700,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje një pajisje UPS për nevojat e një 'Server Room' të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 24 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Gjykata e Tiranës lë në burg 4 personat e akuzuar për sulmin ndaj 50-vjeçarit

I grabitën 60 mijë dollarë kambistit, Elvis Tafa: E goditëm me levë në rrugë

"Na detyruan 2 persona të tjerë, se iu kishim borxhe"

TIRANË

Gjykata e Tiranës dje caktoi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj katër personave të arrestuar për grabitjen e kambistit Agron Shima. Ngjarje kjo e ndodhur paraditen e së premtes në Rrugën e Barrikadave kryeqytet. Gjatë seancës gjyqësore, togat e zeza lanë në qeli të akuzuarit: Elvis Tafa, Elbis Berisha, Blenard Hoxha dhe Xhoni Dido. Më herët prokuroria zbardhi dëshminë e Elvis Tafa. 35-vjeçari Tafa është një nga personat që u arrestua në flagrancë nga policia rrugor. Para oficerëve të Policisë Gjyqësore, Tafa ka deklaruar se e ka realizuar vjedhjen me dhunë të kambistit në bashkëpunim me Xhoni Dido. Ai ka pohuar se e kishin studiuar vendin ku do grabisin dhe personin disa ditë më parë. I riu tregoi gjithashtu të gjithë skenën e grabitjes.



Arrestimi i Elvis Tafes, gjatë grabitjes së kambistit

"Të premtën dola nga shtëpia në 05:00 dhe shkova takova Xhoni Dido në Kthesa e Kamzës. Atje kemi ndërruar rrobat dhe përmes një motori të Xhoni kemi shkuar tek 9-Kateshet. Disa ditë më parë Xhoni më kishte treguar për vendin dhe personin që do grabisnim. Kur mbërritëm tek vendi, kemi ndaluar motorin dhe kemi bërë sikur po i rreg-

ullonim gomën. Pas 20 minutash aty po kalonte kambisti me motor. Xhoni i ra me levë dhe ai ra nga motori. Pasi i mori lekët, hipëm në motor, ku i jepja unë dhe u drejtua nga Rruga e Barrikadave. Te kryqëzimi pashe një makinë policie dhe desha të devijoj, por Xhoni më tha të ecja drejt. Megjë nuk iu binda, ai më qëlloi me levë dhe

kam humbur ekuilibrin duke rënë nga motori. Ai u largua me lekët", - tregoi Tafa. I riu ka thënë ndër të tjera se ata janë detyruar nga dy persona të tjerë të kryejnë grabitjen, për shkak se iu kishin borxhe. "Për të kryer vjedhjen na kanë shtyrë Elvis Berisha dhe Blenard Hoxha, të cilëve u kishim borxhe", - tregoi ai më tej. Ndërkohë, në përfundim të leximit të dëshmisë, Tafa i mohoi deklaratimet duke i cilësuar të pavërteta. "Më kanë dhunuar, nuk i kam thënë unë". Ndërsa avokati i Tafes u shpreh se, "deklaratimet janë të sakta askush nuk e ka dhunuar kam qenë unë prezent", theksoi avokati. Kambisti u sulmua me levë dhe me thikë, ndërsa iu morën gjatë grabitjes 60 mijë dollarë. Elvis Tafa u arrestua nga një efektivi i rrugës, i cili pasi nuk i përgjigji shenjës për të ndaluar iu hodh duke e bllokuar.



Vrasja e Marvi Mihalit

Mbyllet shqyrtimi, Bitraj pranon krimin

Gjykata e Tiranës ka mbyllur ditën e djeshme shqyrtimin gjyqësor për 4 të pandehurit, për vrasjen e Marvi Mihalit, verën e vitit 2017. Tre të pandehur, Eugen Bitraj, Kridens dhe Marsel Alla kërkuan pajafësinë për akuzat. Ndërkohë, avokati i Dejvis Bitrajt kërkoi ndryshimin e veprës penale, duke pranuar vrasjen, por të kryer përtej kufijve të mbrojtjes. Gjykata shtyu seancën dhe vendimin përfundimtar do ta japë në 11 prill, ora 12:00. Ndërkaq, Prokuroria e Tiranës ka dhënë pretendencën për 4 të akuzuarit e vrasjes së 22-vjeçarit Marvi Mihalit për një karikues telefoni, ngjarje e ndodhur në korrik 2017. Prokuroria ka kërkuar 24 vite burg për Dejvi Bitrajn, 20 vite burg për Marsel Allën, 25 vite burg për Kridens Allën, 18 vite burg për Eugen Bitrajn. Studenti i Juridikut, Marvi Mihalit, humbi jetën, pasi u qëllua me thikë në zemër pak para mesnatës së 1 gushtit 2017, në një rrugicë pranë stadiutit "Selman Stërmasi" në kryeqytet. Bazuar në dëshmitë dhe provat e sekuestruara është mësuar se viktimja e krimin, shtetasi Marvi Mihalit, është qëlluar egërsisht tetë herë me thikë duke i marrë jetën. Thika që është përdorur në vrasje është hedhur prej autorëve në lumin e Lanës pak minuta pas krimin, duke humbur gjurmët, por prokuroria ka gjetur disa prova të tjera në lidhje me akuzën për këtë rast. Sipas organit të akuzës, është shtetasi Eugen Bitraj, 24 vjeç, banues në Tiranë, i akuzuar si autori i vrasjes së Marvi Mihalit, më konkretisht si personi që ka qëlluar me thikë viktimën. Caktimi i masës së sigurimit për katër shtetasit mësohet se është bërë për kryerjen e veprave penale të "vrasjes me dashje e kryer në bashkëpunim", parashikuar nga nenet 76 dhe 25 e Kodit Penal dhe "pengimi në zbulimin e së vërtetës".

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

OPEN CALL FOR TENDER

PREQUALIFICATION

- GENERAL CONDITIONS**
- 1.1. Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1
- 1.2. Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in economic development, legal reform, vocational education and training, reform of the water sector, rural development, reforms on strengthening of the internal security, and other areas.
- 1.3. Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified companies to express their interest in providing office furniture's such as table, chairs, bookcase, etc.

1 Companies should fulfil the following requirements:

- The products should be 'brand name' and the company should be an authorized partner for Albania from manufacturer, for selling and supporting the brand(s) products they offer.
- The company should be an authorized service provider for the products it will offer.
- The economic operator must submit evidence of the official test results issued by authorized institutions certifying the compliance of the products with the technical specifications
- The company participating must have the Manufacturer's ISO 14001 certificate.
- The ecological panel of the manufacturer realized 100% wood after consumption.
- Certificate of OHSAS 18001 manufacturer for design, manufacture and assembly of office furniture.
- Manufacturer iso 9001 certificate for design, installation and fitting of the offices
- The firm that will participate in the race, has the manufacturer's authorization.

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

3 The due date for submitting the application is **8th of April 2019**. The application, and any related documents if applicable, should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Procurement of respective equipment for the project "Sustainable Development of Rural Areas", addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1 Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

Kundër zgjatjes së hetimeve, rrëzohet ankimi i ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla

TIRANË - Hetimet për ish-prokuroren e përgjithshëm Adriatik Llalla, ndaj të cilit rëndojnë dyshimet për 4 vepra penale, do të vijojnë edhe përgjatë tre muajve të ardhshëm. Gjykata për Krime të Rënda vendosi të rrëzojë ankimin e ish-zyrtarit të lartë, i cili përmes avokatit Sokol Hazizaj, kundërshtoi vendimin e prokurorisë për zgjatjen e afateve të hetimit. Prokuroria pak ditë më parë i dha kohë vetes edhe 90 ditë për të vijuar hetimet ndaj Llallës, me argumentin se ishte në pritje të një letërporosie dërguar në Gjermani, nga e cila shpreson për të dhëna me interes për çështjen. Kjo përdërisa ka dyshime se Adriatik Llalla është ndaluar në kufi nga autoritetet gjermane disa kohë më parë, pasi udhëtoi me një shumë parash mbi kufirin e lejuar nga ligji. Në seancën gjyqësore të zhvilluar me detyrë të mbyllura, avokati Hazizaj këmbënguli që gjykata të urdhëronte institucionin e akuzës për përfundimin e hetimeve dhe marrjen e një vendimi për dosjen Llalla, për sa kohë sipas tij prokuroria ka pasur kohën e nevojshme për të kryer të gjitha veprimet.

ish-prokurori i Përgjithshëm Adriatik Llalla

LETËRPOROSIA

Prokuroria pak ditë më parë i dha kohë vetes edhe 90 ditë, për të vijuar hetimet ndaj ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla, me argumentin se ishte në pritje të një letërporosie dërguar në Gjermani, nga e cila shpreson për të dhëna me interes për çështjen.

Megjithatë, gjykata i rrëzoi pretendimet e tij. Hetimet ndaj ish-kryeprokurorit, të cilit iu ndalua dhe hyrja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkë me familjen, nisën thuajse një vit më parë fillimisht në Prokurorinë e Durrësit. Me vonë dosja u transferua në Prokurorinë për Krime të Rënda, e cila vendosi të sekuestronte disa pronat e ish-kreut të institucionit qendror të akuzës, me vlerë të konsiderueshme. Ndaj Llallës rëndojnë dyshimet për shpërdorim detyrës, fshehje pasurie, mosdeklarim të hollash në kufi dhe pastrim parash.

Drejtori i Policisë së Shtetit: Ngjarjet në qytetin verior nuk kanë nisur së fundmi

Vrasjet në Shkodër, Ardi Veliu "jep fjalën": Ngjarja do zbardhet e plotë

TIRANË

Drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu i ftuar në emisionin "A Show" në "News 24" u shpreh i bindur se ngjarja e rëndë në Shkodër, ku mbetën të vrarë dy vëllezër, do të zbardhet në kohë rekord.

Ai tha se qyteti i Shkodrës vijon të jetë një qark problematik, ndërsa solli të dhëna që tregojnë se vrasjet në qytetin verior nuk kanë nisur së fundmi, por sipas tij, që nga viti 1999 janë shënuar plot 96 ngjarje me armë. Duke folur për grupet kriminale, Veliu pohoi se në Shkodër është goditur një grup kriminal, por edhe pjesa e fajdeve, ku vetëm disa ditë më parë u arrestuan mbi 10 persona si të përfshirë në këto skema. Ai tha se po hetohen edhe grupe të tjera kriminale, ndërsa ky proces shtoi ai, është në fazën e dokumentimit të provave ligjore. "Ne kemi bërë ndryshime edhe në qarqet e tjera. Ju jeni dëshmitar ku në 2018 u godit një ndër grupet kryesore në Shkodër, që u arrestuan disa persona, por edhe një grup tjetër i fajdeve me prangosjen e 15 personave. Fenomeni i fajdeve në Shkodër është shumë i përhapur. Ne kemi bërë studimin e të gjithë kriminalitetit në qytet dhe në të gjitha



qarqet. Një grup është goditur, grupet e tjera janë nën hetim. Koha e hetimit është duke u maturuar. Informacionet e grumbulluar duhet të kthehen në prova dhe t'i dërgojmë pastaj në

prokurori. Absolutisht ne i kemi të gjitha kapacitetet njerëzore dhe logjistike për të dominuar mbi kriminalitetin. Panorama e bashkëpunimit të policisë me komunitetin është e ndryshme

në qarqe të ndryshme. Për të patur një çelës suksesi e bazojmë tek besimi me qytetarët. Nga njoftimi që bëne qytetarët vjet në Lezhë shpëtuan dy persona nga vrasja, ndërsa ka patur

NGJARJET

Nga shkurti i 1999 deri sot vetëm në qarkun e Shkodrës janë plot 96 ngjarje me armë të pazbuluara. Kjo nuk është shfaqjesim. Ky numër ka ardhur duke u ulur. Fuqia zbuluese është 50 për qind. Kjo do të thotë se ne nuk po punojmë.

edhe sekuestrim armësh. Në Shkodër kemi një situatë ku edhe qytetarët ngurojnë të japin informacion për policinë. Të bëhen pjesë për kontributin e tyre, që konstatojnë një kundra va-

jtje etj. Le të na provojnë, të raportojnë. Drejtori i ri në Shkodër ka eksperiencë të madhe në Polici.

Vendosja e Brahimit në krye të policisë së Shkodrës është vendim kolegjal dhe është njëherësh kompetencë e Drejtorisë së Policisë. Ministri nuk ndërhy në kompetencat e Policisë së Shtetit. Shkodra është vend kufitar. Shkodra është vend kufitar. Shkodra është vend kufitar. Nuk kam ardhur këtu për t'u shfaqësuar, por për të treguar edhe punën e jashtëzakonshëm që po bën aktualisht policia. Nga shkurti i 1999 deri sot vetëm në qarkun e Shkodrës janë plot 96 ngjarje me armë të pazbuluara. Kjo nuk është shfaqjesim. Ky numër ka ardhur duke u ulur. Fuqia zbuluese është 50 për qind. Kjo do të thotë se ne nuk po punojmë. Ngjarja do të zbardhet. Të jeni të sigurtë se kjo ngjarje do të zbardhet", tha Veliu.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



BURSAT NË UNIVERSITETE PROCEDURAT

Vendimi për përgjysmimin e tarifave për bachelorin. Sa do të paguajë masteri?

Voltiza Duro

Procedura për të marrë paratë e bursës për vitin akademik 2018-2019

"Studentë, drejtohuni pranë zyrave të financës në fakultetet tuaja"

Të gjithë ata studentë që iu ka lindur e drejta e përfitimit të bursës, por që nuk e kanë plotësuar dokumentacionin e kërkuar, duhet të paraqiten pranë degëve të Financës së fakulteteve ku studiojnë. Sipas një njoftimi të publikuar nga Fakulteti i Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës, studentët duhet të dorëzojnë edhe numrat e llogarive të tyre, me qëllim akordimin e bursës. "Studentët kanë të drejtë të marrin bursë sipas dy VKM-ve: VKM nr.903, datë 21.12.2016 'Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë' (i ndryshuar), VKM nr. 784, datë 26.12.2018 'Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë'; VKM nr.39, datë 23.01.2019 2018 'Për disa ndryshime në VKM nr.903, datë 21.12.2016 'Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë', - thekson FHF.

PËRGJYSMIMI I TARIFAVE

Ashtu siç ishte paracaktuar, studentët që ndjekin studimet në nivelin e parë të studimeve bachelor do të përfitojnë përgjysmim tarifash. "Për të realizuar me efektivitet procesin e arkëtimit të të ardhurave nga tarifat e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019, rikujtojmë edhe një herë se bazuar në VKM nr.778, datë 26.12.2018 'Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr.288, datë 21.05.2018 'Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të



Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, Studentët e ciklit të parë (bachelor) do të paguajnë 50% të tarifës, pra 15,000 lekë", - thuhet në njoftim.

TARIFË ZERO

Ndërkohë, studentët e ciklit të parë (bachelor), të cilët u përkasin kategorive përjashtimore dhe janë me mesatare 9-10, sipas VKM nr. 779, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifat e shkollimit", si dhe VKM nr.40, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesë në VKM nr.269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kri-

Të gjithë studentët duhet të pajisen paraprakisht me faturën e arkëtimit, sipas Urdhrit Nr. 95, datë 11.11.2009 të Ministrisë së

Financave, e cila pasi nënshkruhet nga institucioni një kopje i dorëzohet studentit nga punonjësja e informacionit për të kryer veprimet në "Alpha Bank".

Paraqitja e faturës tatimore është kusht i domosdoshëm për veprimet në bankat e nivelit të dytë. Pas pagesës, studentët e dorëzojnë kopjen e mandatit tek punonjësja e informacionit, e cila kryen më tej veprimet e dorëzimit në degën e financës.

teret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifat e shkollimit", pra nuk do të kryejnë asnjë pagesë për tarifën e shkollimit të vitit akademik 2018-2019.

BURSAT NË MASTER

Studentët e ciklit të dytë të studimeve (master profesional dhe master shkencor) që u përkasin kategorive sociale në nevojë dhe janë me mesatare 9-10, të cilët përfitojnë 50% ulje të tarifës së shkollimit do të paguajnë 30,000 lekë për studentët e masterit profesional dhe 37,500 lekë për studentët e masterit shkencor, sipas VKM nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet Publike të Arsimit të

TARIFAT

Studentët e ciklit të parë (bachelor), të cilët u përkasin kategorive përjashtimore dhe janë me mesatare 9-10, sipas VKM nr. 779, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifat e shkollimit"

BURSAT

Studentët e ciklit të dytë të studimeve (master profesional dhe master shkencor) që u përkasin kategorive sociale në nevojë dhe janë me mesatare 9-10, të cilët përfitojnë 50% ulje të tarifës së shkollimit do të paguajnë 30,000 lekë për studentët e masterit profesional dhe 37,500 lekë për studentët e masterit shkencor, sipas VKM nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë".

fitojnë ulje të tarifës, sipas VKM nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", do të paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik 2018-2019: 60,000 lekë për studentët e masterit profesional dhe 75,000 lekë për studentët e masterit shkencor.

FATURA E ARKËTIMIT

Të gjithë studentët duhet të pajisen paraprakisht me faturën e arkëtimit, sipas Urdhrit Nr. 95, datë 11.11.2009 të Ministrisë së Financave, e cila pasi nënshkruhet nga institucioni një kopje i dorë-

zohet studentit nga punonjësja e informacionit për të kryer veprimet në "Alpha Bank". Paraqitja e faturës tatimore është kusht i domosdoshëm për veprimet në bankat e nivelit të dytë. Pas pagesës, studentët e dorëzojnë kopjen e mandatit tek punonjësja e informacionit, e cila kryen më tej veprimet e dorëzimit në degën e financës. "Të gjitha aktet ligjore që kanë lidhje me bursat e studentëve dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2018-2019 janë në faqen zyrtare të FHF: eëë.fhf.edu.al. Studentët që kanë paqartësi dhe kërkojnë sqarime të mos hezitojnë të paraqiten pranë degës së financës dhe administratorit të FHF", - shton më tej FHF.

Flet kreu i ISSH-së: Pensioni minimal shkon 13753 lekë, maksimali 26757 lekë

Hado: Përfitues 665 mijë persona, ja shtesa për çdo kategori

Rriten pensionet me 2.8%, shpërndahet fondi 2.3 miliardë lekë

Nis rritja e pensioneve për 665 mijë përfitues. Pensioni minimal shkon 13753 lekë, nga 13378 lekë që ishte deri tani, ndërsa pensioni maksimal shkon në 27 506 lekë në muaj, nga 26757 lekë në muaj që ishte deri tani. Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado, në një konferencë për media ka shpjeguar grafikun e rritjes së pensioneve për çdo kategori. "Deri tani janë paguar 38148 pensione, të cilët të gjithë e kanë marrë pensionin të indeksuar. Pensionet minimale kanë arritur vlerën e 13753 lekë nga 13378 lekë që kanë qenë. Ndërsa, pensioni maksimal ka arritur në 27 506 lekë nga 26757 lekë të reja që ka qenë", - tha Hado. Sipas tij, janë 665 mijë pensionistë në vend, të cilët duke nisur nga dje do të marrin pensionin të indeksuar. Drejtori i përgjithshëm, Astrit Hado, deklaroi se indeksimi i pensioneve është 2.8% dhe tashmë ka nisur shpërndarja sipas grafikun. "Kjo rritje është bërë për të eliminuar efektin e rritjes së çmimeve të produkteve. Nëse një pensionist merr një pension prej 10 mijë lekësh në muaj, përfiton një rritje prej 280 lekësh", - tha Hado. Kreu i ISSH ka konfirmuar fondin e vënë në dispozicion për indeksimin e pensioneve. "Fondi i vënë në dispozicion është 2.3 mld lekë dhe nga ky indeksim përfiton të gjitha llojet e pensioneve", - tha kreu i ISSH-së, Astrit Hado.



Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado

PËRFITUESIT

Këshilli i Ministrave vendosi në mbledhjen e fundit rritjen e pensioneve në masën 2.8%. Në dispozicion të rreth 665 mijë pensionistëve është vënë një fond prej 2.39 miliardë lekësh. Pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore përveç rritjes me 2.8%, do të përfitojnë edhe kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit, me kusht që shumica e pension-

it mujor plus kompensimin e të ardhurave, të jetë: a) deri në 15 403 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë; b) deri në 14 903 lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare; c) deri në 10 108 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare. Kompensimi për të ardhura mujore minimale nisur nga 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që shumica e pensionit mujor të parakoh-

hëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 403 lekë në muaj. Janë 16 kategori pensionesh që përfitojnë rritjen. Në vendim është përcaktuar edhe kufiri minimal dhe maksimal për pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.4.2019 e në vazhdim dhe përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993. Sipas vendimit, mësohet se përfitojnë rritje pensionet e caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", pensionet sociale. Shtesë mujore në masën 2.8% do të përfitojnë edhe personat që trajto-

PENSIONET	
Pension minimal	
■ Ishte	13378 lekë në muaj
■ Bëhet	13753 lekë në muaj
Pension maksimal	
■ Ishte	26757 lekë në muaj
■ Bëhet	27 506 lekë në muaj

veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar dhe rastet e trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetësive dhe palombarëve të forcave detare në pension". Rritja do të aplikohet për personat që trajtohen me pagesa të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", pensionet suplementare të caktuara sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë titull shkencorë". Për efektet në pikën dy të vendimit të Këshillit të Ministrave përcaktohet se indeksimin e pensionit e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.3.2019, përfshirë edhe këtë datë.

Manastirliu: Brenda këtij viti do të bëhet rehabilitimi i 100 qendrave shëndetësore në mbarë vendin

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, panga afër investimin e kryer në rehabilitimin e plotë të pikës së ambulancës Tufinë, në bashkëpunim me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA). "Programi ynë i rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore po vijon në çdo komunitet, qendër dhe periferi, për të ofruar një standard të ri shërbimi në kujdesin parësor, në bashkëpunim me partnerët tanë, siç është rasti i ambulancës së Tufinës. Pjesë e këtij programi janë 100 qendra shëndetësore, që do të rehabilitohen këtë vit", - tha Manastirliu. Gjatë inspektimit, Manastirliu u shpreh se bashkëpunimi me agjencinë turke do të vijojë me autoambulancat që do të përmirësojnë shërbimin e urgjencës. "Vijojmë jo vetëm investimin në infrastrukturë, por me Agjenc-



inë Turke për Bashkëpunim, së shpejti pesë autoambulanca moderne do t'i shtohen shërbimit të urgjencës", - tha ministria. Sipas njoftimit, ambulanca Tufinë është një nga 7 pikat e ambulancave të Qendrës Shëndetësore Dajt, duke mbuluar me shërbim shëndetësor tashmë me një standard të ri, banorët e katër fshatrave: Tufinë, Tujan, Brarë, Ferraj. 320 mijë

banorë të Tiranës dhe rrethina kanë përfutur shërbime me cilësore me rehabilitimin e 17 qendrave shëndetësore, të cilat janë përfshirë deri tani në programin e rikonstruksionit të 300 qendrave shëndetësore, nga të cilat 15 kanë përfunduar. Gjithashtu, brenda muajit maj përfundon edhe rikonstruksioni i dy qendrave shëndetësore, Vorë dhe Saurk.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e botimeve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,068,400 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraqitsh pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypja e botimeve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **25 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku tohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Grëfhet artisti: S'kam dhënë as 30% të talentit tim, 10 vite larg ekranit, ja ç'kam bërë

Erion Korini:

Shkëputja ime nga muzika, detaje nga angazhimet e reja

"Vëmendja përtej talentit që të ka dhënë Zoti është primitivitet"

Egla Xhemali

Një shkëputje e befë nga bota e muzikës, për një rrugëtim të ri në Ora News. Padyshim që të gjithë i mbajnë mend hitet e tij. Erion Korini vjen në një rrëfim ekskluziv për "Gazeta shqiptare" për të ndarë me ne mungesën 10-vjeçare në ekran, angazhimet e reja, gjërat që nuk toleron tek artistët e rinj, pasionet e pengjet, si dhe refrenin, me të cilin nis dita e tij. Larg vëmendjes së medias, ai ka bërë një jetë krejt normale mes familjarëve dhe miqve të ngushtë. Sa i përket muzikës, Korini thotë se nuk ka dhënë as 30% të talentit të tij, megjithatë tek të rinjtë thekson se bie më në sy dukja se sa përmbajtja. Si në çdo profesion tjetër edhe radioja do përkushtim e aq më tepër kur ke më shumë përgjegjësi se të tjerët. Magjia e saj është të dish të jesh ndryshe në atë që transmeton për dëgjuesin pohan artisti. Larg gjithçkaje, në përditshmeri ai di të tjerët. Magjia e saj është të qeshurash na bën me dije se është më korrekt se ç' duhet. Korini është i parimit që ta shijojmë jetën në maksimum për sa kohë që jetojmë në tokë e mos të humbasim kohë duke menduar për pengjet.

Cfarë nuk dimë nga periudha e gjatë e shkëputjes suaj nga muzika?

Nuk kenim humbur asnjë gjë interesante. Kam bërë një jetë normale si gjithë të tjerët larg vëmendjes së shumicës dhe afër vëmendjes së atyre që më duan vërtetë, familjes dhe miqve të mi të ngushtë. Gjithmonë kam menduar se të kërkuarit vëmendje përtej talentit që të ka dhënë Zoti, tingëllon primitivitet, kështu që këto kohë s'kam pasur asgjë interesante për të treguar e kam preferuar të mos 'shfaqem' duke qenë se jam larguar nga kënga këto vite.

Angazhimet tuaja të momentit?



Punoj prej 9 vitesh në "Ora News", që së shpejti do të jetë vetëm Ora pa news. Jam në detyrën e drejtorit të radios dhe zërit zyrtar të TV. Përveç këtij angazhimi jam edhe bashkëpunëtor në një iniciativë të re, në një studio filmi, ku merremi me prodhimin e videove dhe audiove, reklama, dokumentarë etj.

Gjëja që nuk toleroni tek artistët e rinj?

Shumë dukje dhe pak

përmbajtje.

Si është ndjesia e të punuarit në radio?

Radio është dashuri. Ata që kanë punuar në radio flasin gjithë pasion, kur u përmend fjalën radion, por pasioni nuk mjafton pasi duhet të studiosh, të azhurnohesh dhe të formohesh profesionalisht, për t'u bërë pjesë harmonike e procesit dhe mekanizmit të radios. Ajo që është më e rëndësishmja që i pason këto që thashë më



sipër është të dish të jesh ndryshe në atë që transmeton në frekuencën tënde. Pra, nuk është e thjeshtë dhe dihet që asgjë e bukur nuk vjen aq thjeshtë në kohët që jetojmë.

Oferta më e çuditshme që ju është bërë për hir të punës?

Meqenëse unë përgjithësisht jam i qartë me ata që më rrethojnë dhe ua bëj të qartë talentet dhe limitet e mia nuk para kam marrë of

erta që të më habitin, por dikur habita veten time kur i propozova vetes të merresha me blegtori domethënë, të ndërtoja komplekse stallosh. (qesh) Kur shkoja i vogël në fshat me pushime isha shumë kurioz të vizitoja stallat, të shihja teksta i ushqen apo i milnin bagëtisë. Sot, shoh që është bërë një treg i sigurt dhe i madh i këtyre produkteve dhe ku i dihet pas të 60-ave edhe mund të merrem me

këtë gjë.

Pasionet që ju thërrasin së brendshmi?

Pasioni im është muzika dhe udhëtimi, por punët që bëj më kanë larguar pak nga të dyja. Po të më kishte lënë gjyshi trashëgimi dy puse naftë mbase do kisha udhëtuar më shumë. (qesh)

Cili është pengu më i madh që kenit nga rrjedha e kohës?

Vijmë nga asgjëja dhe shkojmë drejt asgjësë, kështu që me këtë shpejtësi që fluturon jeta na duhet të jetojmë shëndetshëm, për sa kohë jemi mbi tokë dhe të mos humbim kohë duke menduar pengjet.

Përtej shkëlqimit në ekran, si është Erioni?

Unë në repertorin tim kam pasur disa hite, por përsëri nuk i shoh si shkëlqim sepse mendoj që duhet të kisha dhënë më shumë dhe të mos gjykoheja thjesht për aq sa kanë parë në ekran nga unë. E di që s'kam dhënë as 30% të talentit dhe ky është faji im. Sa i përket pjesës se si jam në jetën e përditshme dua t'ju them se jam shumë korrekt madje ndonjëherë ta shpif me këtë korrektësi. (qesh) Jam i qeshur dhe nuk kuptoj arsye pse njerëzve që më njohin nga larg u dukem i vrazhdë dhe shumë mendjemadh. Çdo ditë e nis me mendime shumë të bukura, por kur dal nga shtëpia për t'i realizuar planet e ditës e kuptoj që nuk është siç e mendoja, megjithatë përpiqem të përshtatem brenda asaj që më lejon karakteri. Dua të jetoj në harmoni me atë që më rrethon edhe pse është shumë e vështirë kjo që dua në këtë botë shumë komplekse.

Refreni me të cilin nis dita tuaj?

Në qoftë se e ke fjalën për moton time nuk kam asnjë moto, por siç thashë më sipër dua të jetoj në harmoni me njerëzit që rrethohem, për sa kohë edhe ata e duan diçka të tillë. Nëse e ke fjalën për ndonjë refren të vërtetë kënge mundohem që t'u iki kafeneve të mëngjesit që transmetojnë popullore ose rrep dhe vrapoj për tek makina ime të dëgjoj ndonjë refren nga Sting.



Dha lajmin e keq për fansat e saj, ja si reagan ata për Luana Vjollcën

Ajo është një ndër moderatorët më të mira shqiptare dhe shumë e dashur për publikun. E kemi fjalën për Luana Vjollcën. Ditën e djeshme, moderatorja simpatike ka bërë një deklaratë që me siguri i ka mërziur fansat e saj. "Kam vendosur të tërhiqem për ca kohë, 12 vite pa u ndalur. Kam nevojë të pushoj. Do më marrim malli shumë për dashurinë tuaj." shkruan Luana në postimin, në të cilin replikuan shumë nga ndjekësit e saj. Teksa i uronin pushime të mbara dhe i tregonin se do ta prisnin deri kur të kthehej, moderatorja ka publikuar një tjetër bisedë me një ndjekëse, duke treguar se gjithçka ishte në kuadër të 1 Prillit. "Mesazhet tuaja si kjo ma shkruan zemrën komplet! Kështu që po ju tregoj që as në mend s'e kam që të ndalem. Jam e bekuar që ju kam! Gëzuar 1 Prillin! Hajt se duhen ndonjëherë gënjeshtër të tilla që të më kujtohet sa shumë dashuri kam", shkruan Luana në 'Instagram'.



E pyetën për rrogën, zbuloni si përgjigjet Ermal Mamaqi

Ermal Mamaqi është një ndër aktorët dhe moderatorët më të pëlqyer nga publiku. Së fundmi, ai ishte i ftuar tek 'E diell', Ermali është pyetur se sa e ka rrogën. Mirëpo, ai ka devijuar nga pyetja dhe ka dhënë një përgjigje mjaft diplomatike. 'Unë kam disa rroga. Këto ndahen në të ardhura pasive si për shembull dhënia me qira e një apartamenti, që do të thotë se ti nuk punon për to, dhe të ardhura aktive, që ti punon dhe merr një rrogë në fund të muajit. Në momentin kur të ardhurat pasive janë më të mëdha se shpenzimet e tua, atëherë ti mund të pushosh nga puna bosin tënd', tha Mamaqi. Gjithashtu, shtoi se: 'Kjo është pyetje tipike shqiptarësh. Ku po shkon dhe sa e ke rrogën janë karakteristike e kombit tonë aq sa edhe të huajt çuditën me ne për këtë pjesë'.



Pas ndarjes, ja çfarë surprize i bën iraniani miliarder Morena Tarakut

Fundi i raportit të tyre u komentua gjatë nga mediat rozë. Morena e ofendoi rëndë miliarderin iranian, Sasha Sobhanin duke e quajtur atë gay e megjithatë ky i fundit vazhdon të na surprizojë me sjelljen e tij.

Që pas ndarjes së çiftit, nuk kemi parë ndonjë djalë tjetër në jetën e Morena Tarakut, mirëpo para pak javësh ajo publikoi një foto, në të cilën u shfaq me një unazë me diamant gjigant në gishtin e fejesës dhe shkroi: "Thashë po" si për të na lënë të kuptojmë që është fejuar. Mbrëmjen e së dielës të gjithë fansat e Sashës janë çuditur teksa ai ka vendosur që të urojë publikisht Morenën për ditëlindjen. Iraniani ka publikuar një foto të ish-partneres së tij në 'Instastory' dhe pranë saj ka bërë një urim për ditëlindjen dhe ka etiketuar bukuroshe brune. Ndërkohë Morena nuk ka reaguuar lidhur me urimin e ish-partnerit të saj, por thjesht ka publikuar dhuratat që ka marrë për ditëlindje.



Një bashkëpunim i ri në horizont! Mozzik bëhet bashkë me reperin e njohur

Mozzik prej kohësh e ka shprehur admirimin e tij, për reperin Unikkatil. Ai shpeshherë e ka cilësuar Unikkatil si njeriun që ka hedhur themelet për repin e gjeneratës së re, në të cilën ai bën pjesë. Në këtë mënyrë një bashkëpunim midis tyre do të ishte diçka logjike, për respektin që kanë ndaj artit të njëri-tjetrit, por edhe pse fansat e kërkojnë me ngulm një gjë të tillë. Në këtë mes qëndron edhe Loredana, bashkëshortja e Mozzik, e cila është edhe ajo një repere e suksesshme, gjithashtu. Në "InstaStory-n" e saj një fans ka shkruar "Mozzik and Unikkatil?", ndërsa Loredana ka reaguuar me një emoji që nënkupton heshtjen. Një mesazh i koduar ky që nënkupton se shumë shpejt do të kemi një bashkëpunim midis dy artistëve.



Deputeti gjerman: Kundërshtojmë këmbimin e territoreve

Peter Bayer: Do jemi partnerë mbështetës i Kosovës për proceset e ardhshme

Gjermania e kundërshton idenë e këmbimit të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, tha të hënën në Prishtinë deputeti i Bundestagut, Peter Bayer. "Ne jemi në vizitë zyrtare, por ne jemi me miqtë tanë. Biseduam për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Kemi folur për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, të cilin e mbështesim, por edhe për temën e këmbimit të territoreve, të cilën Gjermania e kundërshton

fuqishëm. Ne do të jemi partnerë mbështetës i Kosovës për proceset e ardhshme, sigurisht me një sy kritik", tha Bayer. Këto komente ai i bëri pasi së bashku me deputetin tjetër gjerman, Christian Schmidt, takuan kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj. Siç njofton Zyra e Kryeministrit, gjatë takimit,

Haradinaj bisedoi me deputetët gjermanë për procesin e dialogut me Serbinë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, duke shprehur përkushtimin e Kosovës për arrijtjen e një marrëveshjeje që do të rezultonte me njohje të ndërsjellë. Po ashtu, në takim u bisedua për bashkëpunimin ndërmjet Kos-

ovës dhe Gjermanisë, por edhe për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës ideja për ndryshimin e kufirit është shpërfaqur në opinionin që prej verës së vitit të kaluar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Thaçi, i cili e përfaqëson Kosovën në bisedimet me



Serbinë, ka thënë se në Bruksel do të kërkojë që Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, t'i bashkohen territorit të Kosovës, por kundër idesë së ndryshimit të kufirit është

kryeministri Haradinaj, i cili thotë se prekja e kufijve mund të sjellë tragédi në Ballkan. Qëndrime pro dhe kundër kësaj ideje ka edhe në qarqet ndërkombëtare.

Haradinaj kundër heqjes së tarifës, pasojat e vendimit

A e pengoi taksa idenë për ndryshimin e kufirit Kosovë-Serbi?

Zgjedhjet kosovare në maj, çfarë pritet të ndodhë

Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se vendimi i qeverisë së Kosovës për taksën ndaj prodhimeve të Serbisë ka rezultuar me ndërprerjen e procesit të dialogut ndërmjet dy vendeve dhe rrjedhimisht edhe pengimin e mundësisë që ideja për ndryshimin e kufirit Kosovë-Serbi të shtrohet në dialog. Por, sipas tyre, ky është vetëm rezultat anësor, i cili nuk ishte planifikuar qysh më parë nga ekzekutivi i vendit. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili e kundërshton fuqishëm idenë e ndryshimit të kufijve si zgjidhje e mundshme e kontestit Kosovë-Serbi, në disa raste ka thënë se taksa ndaj produkteve të Serbisë është vendosur, ndër të tjera edhe për pengimin e ndryshimit të kufirit "Me veprimin e marrë për të bllokuar mallrat e Serbisë, pra, taksa prej 100 për qind, është po ashtu veprim që pengon formalizimin e një ndarjeje. Kosova nuk jep tokë për njohje dhe, nëse ky është çmimi, Kosova nuk ka nevojë për njohje nga Serbia", pati thënë Haradinaj, në një prej paraqitjeve të tij. Imer Mushkolaj, analisti i çështjeve politike, thotë se vendosja e taksës ndaj prodhimeve të Serbisë nga qeveria e Kosovës ishte arsyetuar si kundërpërgjigje ndaj politikës dhe diplomacisë agresive të Serbisë ndaj Kosovës. Sipas tij, fillimisht nuk ishte ditur që vendosja e kësaj takse do të kishte efekt ndërprerjen e dialogut nga Serbia. "Pasi Serbia, respektivisht presidenti (Aleksandar) Vuçiq, e kushtëzoi vazhdimin e dialogut me taksën, u pa që taksa po e pengon dialogun. Kjo duket se i shkoi në favor edhe kryeministrit Haradinaj, i cili përmasë taksës e çoi përpara kundërshtimin e tij ndaj ndryshimit të kufijve. Pra, vendosja e taksës nuk e kishite qëllimin kryesor pengimin e dialogut, por me veprimin e Serbisë, për kushtëzimin (e dialogut) me heqjen e taksës, kjo po del se mund ta pengojë dialogun dhe deri më tash e ka bërë këtë", tha Mushkolaj. Artan Murati, analist nga Instituti



Demokratik i Kosovës, vlerëson që me vetë faktin që vënia e taksës për prodhimet e Serbisë dhe mospezullimi i saj nga qeveria e Kosovës, kanë ndikuar në ndërprerjen e dialogut, rrjedhimisht ka ndikuar edhe në mosavancimin e idesë për ndryshim të kufirit Kosovë-Serbi. Sipas tij, në praktikë, i bie që kryeministri ka të drejtë, por mbetet pikëpyetje nëse taksa për mallrat e Serbisë është mënyra më e mirë për ta ndaluar idenë e ndryshimit të kufirit, si zgjidhje e kontestit ndërmjet dy vendeve. Siç thotë ai, kjo masë e ka ndaluar tërësisht dialogun, madje edhe për çështjet që nuk lidhen domosdo me idenë e ndryshimit të kufirit. "Si mekanizëm mbrojtës kjo mund të merret dhe mund të përdoret. Nga ana e kryeministrit apo kujtdo brenda qeverisë, kjo mund përdoret si një lloj karremi dhe po përdoret për ta ndalë

idenë e shkëmbimit të territoreve. Mirëpo, praktikisht, ndalja e kësaj ideje duhet të institucionalizohet, duhet të formalizohet përmes veprimeve në institucionet e Republikës së Kosovës. Taksa mund të konsiderohet si një masë e përkohshme, e cila e ka ndalë idenë e këmbimit të territoreve, mirëpo jo si përfundimtare, sepse këtu duhet veprim shtetëror për një gjë të tillë", theksoi Murati. Megjithatë, njohësit e zhvillimeve politike, thonë se kryeministri Haradinaj, do të vazhdojë ta mbajë në fuqi vendimin për taksën ndaj prodhimeve të Serbisë. Analisti Mushkolaj thotë se partneri më i madh qeverisës, Partia Demokratike e Kosovës dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, do të vazhdojnë përpjekjet që ta bindin Haradinajn për pezullim të kësaj takse. "Ende po provojnë që t'ia mbushin mendjen Haradinajt që ta

heqë taksën dhe që dialogu të vazhdojë. Tash kemi mbetur, si vend, në njëfarë pozicioni interesant, ku Haradinaj po pret garanci ndërkombëtare, me shkrim, në radhë të parë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se çështja e integritetit territorial të vendit nuk do të vihet për diskutim në bisedime. Në anën tjetër, e kemi presidentin Thaçi, i cili, në fakt, po i ngutet që ta vazhdojë idenë e tij për "korrigjimin e kufirit", ndonëse këto muajt e fundit nuk është se e ka promovuar shumë ose që është marrë shumë me të", u shpreh Mushkolaj. Ngjashëm shpreh mendimin edhe analisti Murati. Sipas tij, Haradinaj do të ketë tendencë që ta mbajë në fuqi taksën edhe për shkak se kjo i ka reflektuar pozitivisht në opinionin, gjë që siç thotë ai, është vërejtur edhe në sondazhet e ndryshme. Por, Murati vlerëson se kjo nuk

Vrasja e shqiptarit në burgun grek, Demokracia e re: Turp!

Pas publikimit të videos së vrasjes makabre të shqiptarit Albert Bako në burgun e Koridhalos, Greqi, ka reaguar partia Demokracia e Re. Zëvendës sekretari i kësaj force, Kostas Karagounis, tha se në pushtetin e SYRIZA është normale që të burgosurit të vriten, duke e cilësuar "Turp". "Në Greqinë e SYRIZA tani konsiderohet normale që të burgosurit jo vetëm të organizojnë partinë, por edhe të vrasin njëri-tjetrin", tha Karagounis në zhurmën që ka shkaktuar video-shoku nga burgu Koridhalos, me të burgosurin e vrarë në këtë burg, më 14 janar të këtij viti. "Imazhet e vrasjes brutale në burgun e Koridhalos janë tronditëse", tha më tej Karagounis.



është politikë e mirë e Haradinajt. "Nuk është politikë e mirëfilltë dhe nuk është politikë e orientuar mirë, sepse kjo po na paraqet probleme të natyrave të ndryshme, sidomos me partnerët ndërkombëtarë. E dimë se si i kemi raportet me SHBA-në, prej momentit të imponimit të taksës. Kështu që, besoj që Haradinaj do të mundohet ta mbajë taksën për aq gjatë sa mundet dhe që nuk e rrezikon ndoshta as pozitën e tij, si kryeministër i Kosovës", vlerësoi Murati sidogjftë, ideja për ndryshimin e kufirit Kosovë-Serbi, si zgjidhje e mundshme e kontestit ndërmjet dy vendeve, është shpërfaqur në verën e vitit të kaluar. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi e ka qua-

jtur "korrigjim i kufirit", ndërkaq, presidenti i Serbisë e ka quajtur "përcaftim i kufirit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve". Më 21 nëntor të vitit të kaluar, qeveria e Kosovës ka vendosur taksën prej 100 për qind për prodhimet të Serbisë, vetëm një ditë pas dështimit të Kosovës për anëtarësim në INTERPOL. Shtetet perëndimore, partnerë të Kosovës, përfshirë ato të BE-së dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë kërkuar nga qeveria e Kosovës që të pezullojë vendimin për taksën ndaj prodhimeve të Serbisë, në mënyrë që t'i hapet rruga vazhdimin të dialogut. Deri më tash, kryeministri Haradinaj nuk e ka pezulluar vendimin për këtë taksë.

Sfida e "Merkron" ndaj mbrojtjes, sigurisë dhe kampionëve europianë

Domethënia e vërtetë e Traktatit të Aquisgrana-s

Rritja ekonomike dhe recesioni në BE, çfarë pritet të ndodhë

Në qoftë se flitet për Europën, të gjitha dritat mediatike botërore janë të drejtuar nga demonstrimet e përjavshme e pakënaqësisë sociale, që kanë përfshirë Francën, duke u shprehur nëpërmjet "Jelekverdhëve" dhe duket sikur kontinenti apo deri edhe bota, nëse gjenden gjurmë të gjestit performues të veshjes së jelekëve të emergjencës nga Belgjika në Portugal, deri në Tel Aviv të Izraelit në Tajvan. Më 30 janar, në "The Ëall Street Journal" lexohej se lëvizje të tilla duket se kanë qenë shkaku i humbjeve milionëshe në superstore nga Fnac-Darty tek Carrefour. Konfirmohet se rritja e Francës në 2018 ka zbritur në 1.5%, respektivisht 2.3% të 2017. Parashikimet për Gjermaninë, motor i shenjtë ekonomik, janë akoma më të ulëta: qeveria gjermane i "redukon parashikimet e saj në 1% për 2019 nga 1.8%". Flitet deri për një rrezik recisioni të Gjermanisë. Sigurisht jo të dhëna prej gjigandit ekonomik. Pavarësisht shenjave të qarta të ngadalësimit të rritjes, BQE-ja e Draghi i ka dhënë fund Quantitative Easing në dhjetorin e 2018, domethënë blerjes së titujve shtetërorë nga ana e saj. Megjithatë, Draghi lë të kuptohet në Parlamentin Europian se "është i gatshëm që të përdorë të gjitha instrumentat e politikës ekonomike për të mbështetur rritjen në rast se ngadalësimi do të rezultonte më i fortë, përfshi Quantitative Easing".



PARASHIKIMI

Parashikimet për Gjermaninë, motor i shenjtë ekonomik, janë akoma më të ulëta: qeveria gjermane i "redukon parashikimet e saj në 1% për 2019 nga 1.8%". Flitet deri për një rrezik recisioni të Gjermanisë. Sigurisht jo të dhëna prej gjigandit ekonomik. Pavarësisht shenjave të qarta të ngadalësimit të rritjes, BQE-ja e Draghi i ka dhënë fund Quantitative Easing në dhjetorin e 2018, domethënë blerjes së titujve shtetërorë nga ana e saj. Megjithatë, Draghi lë të kuptohet në Parlamentin Europian se "është i gatshëm që të përdorë të gjitha instrumentat e politikës ekonomike për të mbështetur rritjen në rast se ngadalësimi do të rezultonte më i fortë, përfshi Quantitative Easing".

tike" e ordo - liberalizmit, që shprehet edhe në kohëra shumë të afërta nga "vendimi skandaloz për të ndaluar nëpërmjet rregullimit shkriren e Alstom - Siemens me efekte ekonomike katastrofike". Rënia e lirë e tregtisë globale që është në rënie "shumë vitë përpara proteksionistit selektiv Trump, siç e demonstroi fakti që në 30 vitet e flobalizimit nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje tregtare multilaterale, por vetëm marrëveshje bilaterale". **"Traktati i Aquisgrana: skicofrenia midis simbologjisë politike dhe politikave ekonomike.** Më pak i rënë në sy ka qenë "Traktati i Aquisgrana, inëshkruar më 22 janar 2019, që është në mënyrë të padiskutueshme një protagonist i aktualitetit politik, anipse në hije, ndoshta qëllimisht, nga fakte të tjera kronike. Tek "Il Sussidiario", Augusto Lodoli nënvizon sesa komentatorët i janë referuar Sharlëmanj për t'i dhënë një thellësi historike kësaj ngjarjeje. Megjithatë, duhet kujtuar se në fakte thuajse asgjë perandorake e tij gjendet në takimin midis Macron dhe Merkel. Por tensioni produktiv midis pushtetit tokësor, mbret dhe perandor, dhe shpirtëror, papët, që prodhonte arkitekturat perandorake

nga Mesjeta në dekadencën e 700, me arketipin e Traktatit të Aquisgrana e 1748 që i jep fund luftërave të suksesit austrian, siç kujton Giulio Sapelli, nuk kanë asnjë jehonë në Europën e "Merkron", siç quante muaj më parë "The Economist" miqësinë Merkel - Macron. Bashkimi Europian nuk ka asgjë nga Perandoria e Shenjtë Romake, nëse në letrat kushtetuese e Bashkimit janë ruajtur mirë nga çdo referim kulturor ndaj rrënjëve judeo - kristiane të progresit europian, dhe deri nga laicizimi dhe iluminizimi europian, që i verbër siç është, harron rrënjët e veta kristiane. Në "Financial Times" i referohet me të drejtë Traktatit të Elizeut të vitit 1963, duke shprehur pikëpamje të kundërta rreth kuptimit të këtij azhurnimi në marrëdhëniet bilaterale franko - gjermane: disa, si Ëolfgang Münchau, ftojnë që të mos nënvlerësohet vlera simbolike e impenjimit reciproc të marrë nga të dyja fuqitë kontinentale për ruajtjen e integritetit europian. "Traktati Aquisgrana", shkruan Münchau, "nuk ofron asnjë zgjidhje konkrete, por së paku nënvizon impenjimin reciproc. Në thelb, Gjermania dhe Franca thonë se do të bëjnë gjithçka është e mundur. Ashtu si Shën Agustini

përpara tyre, nuk duan ta bëjnë për momentin". Megjithatë, komenton Münchau, nuk dihet sesa kohë duhet të presim akoma. Nga ana tjetër e spektrit të interpretuesve, gjithmonë në "Financial Times", theksohet se ai nuk është gjë tjetër veçse një takticizëm për të "shmanjur një kompeticion eksplicit ekonomik e diplomatik midis fuqive kontinentale më të forta të Bashkimit Europian dhe të ruhet vëmendja mbi disa projekte të përbashkëta". Arsyja thelbësore e traktatit lëkundur nga strategji afatgjatë për ndërtimin e Bashkimit Europian, e bazuar mbi autonominë strategjike, në instrument të thjeshtë praktik për të shpëtuar të shpëtueshem. Praktikisht, na kujton "Le Monde Diplomatique", Elizeu komunikon se asnjëherë në marrëdhëniet franko - gjermane nuk është bërë fjalë në mënyrë eksplicite për mbrojtje dhe siguri duke lidhur programe ambicioze bashkëpunimi e zhvillimi, si në marrëveshjen e fundit të Aquisgrana. Ato konkretizohen jo vetëm në "Këshillin Franko - Gjerman për Mbrojtjen dhe Sigurinë si organ politik për të qeverisur impenjimet reciproke", që do të mbidhet në intervale të rregullta, siç parashikohet nga Neni 4, Paragrafi 4, por përtej krijimit të një serie të tërë trupash ekspedicionare franko - gjermane, të mbështetura nga një bashkëpunim i plotë zhvillimi industrial, pasi "bangoprovat e parë e vërtetë do të jetë mbrojtja", me projektin Leclerc (shkriroje e tankeve Leopard të gjermanes KMÉ - dhe Leclerc - të francezes Nexter), që duhet ta shikojë realizimin në 2035. Por jo vetëm. Modeli është i njëjtë me Traktatin e Lancaster e 31 janarit 2014, ku nënshkruheshin bashkëpunime të mëdha franko - britanike për kërkimin, me një total prej 145 milion eurosh, dhe zhvil-

limin e teknologjive raketore dhe sistemeve antimish de-tare dhe nëndetare, duke implikuar grupe të mëdha, nga Dassault-Aviation dhe BAE Systems deri tek Rolls-Royce, Safran, Thales dhe Selex Es. Këto bashkëpunime duket se strukturohen edhe falë "fondit europian për mbrojtjen", për të cilin Komisioni ka propozuar një buxhet vjetor prej 1.5 miliard eurosh duke filluar nga 2020, të drejtuar që të "financojë projekte kërkimi dhe teknologjive për mbrojtjen", siç shkruan Alcantara Pannier në Ramses e vitit 2019 (botim vjetor i FRI-t), "të avancuara nga bashkëpunimi midis shumë bizneseve të ndodhura në vende të ndryshme anëtare". Megjithë retorikën e madhe për projektet ambicioze, Gjermania është e gjymtuar nga brenda karshi impenjimeve të armatimeve të marra me Francën: SPD-ja, Die Linke dhe të Gjëlberit e vënë në diskutim vendimin për riarmatimin e marrë nga aleanca e qendrës katolike - sociale, siç na kujton Barbara Kunz gjithmonë në Ramses. Përtej konflikteve ideologjiko - politike të brendshme të Gjermanisë, skicofrenia e madhe midis simbologjisë perandorake të Aquisgrana për një perandori të madhe europiane (me ushtrinë sipas masës së vet) dhe vendimet konkrete të politikës ekonomike, të vetmet që mund të realizojnë ambicje dhe projekte perandorake të tillë, shfaqet akoma më fuqishëm në debatet e kohëve të fundit rreth shkrires së mundshme midis gjermanes Siemens dhe francezes Alstom, dy gjigandët europianë e shpejtësisë lartë. Praktikisht, bashkëpunimet ambicioze në nivel ushtarak nuk mund të ekzistojnë pa një koordinim strategjik në planin gjeo - ekonomik. Nëse hekurudhat dhe shpejtësia e lartë nuk janë një industri ushtarake në kuptimin e ngushtë të fjalës, gjithsesi janë një industri themelore për të ndërtuar rrjetet komunikacioni efektive në territor: kanë një impakt strategjik. Komisarja për Konkurrencën Margrethe Vestager vazhdon e palëkundur që të mëshojë për veton ndaj shkrires. Të mëkurën, më 6 shkurt, Bashkimi Europian e ka bllokuar zyrtarisht shkriren midis dy gjigandëve të shpejtësisë së lartë, duke e preokupuar për dëmet ndaj konkurrencës brenda tij dhe rritjes eventuale të qmiveve të trenave të gjeneratës së ardhshme. Megjithatë, shkrija Alston - Siemens do të krijojte një gjigand "me një fakturim vjetor të kombinuar prej 15 miliard eurosh" dhe kishte mbështetjen e plotë e Emmanuel Macron, "që ka thënë se do

të krijonte ekuivalentin e hekurudhave të prodhuesit europian të avionëve Airbus SE", siç përcjell "The Ëall Street Journal". Megjithatë, homologët gjerman dhe francez, Bruno Le Maire dhe Peter Altmaier (CDU), vazhdojnë që ta kritikojnë zgjedhjen e Brukselit. Deri Joe Kaeser, CEO-ja i Siemens, sipas asaj që përcjell "Financial Times", pohon se "regjimi i konkurrencës" i Brukselit është "backëard", domethënë i prapambetur. I prapambetur për sfidat globale me të cilat industria europiane duhet të përballlet në mes të gjigandëve kinezë e amerikanë që shfaqen falë vendeve që e ngrenë ekspansionin e tyre ekonomik pikërisht mbi grupet e mëdha multikombëtare. Thëkson edhe se mbrojtja e konsumatorëve lokalisht nuk nënkupton që ta pengojë Bashkimin Europian të jetë konkurrues në nivel global. Megjithëse janë shpenzuar autoritetit kombëtare gjermane dhe britanike, por edhe gjigandit kanadez Bombardier Inc., në mbështetje të linjës së Komisionit Europian, kundër argumentave politike për të krijuar një "kampion europian" të hekurudhave, vazhdojnë akoma protestat nga ana e Berlinit dhe e Parisit. Është edhe realizimi politik i shprehur nga Franca, nëpërmjet Le Maire, që do të duhet t'u hapë sytë burokratëve të Brukselit, ndërsa nënvizon sesa jo vetëm ligjet për konkurrencën janë të "prapambetura", por edhe se "bllokimi shkrires do të ishte një "gabim politik" që e lë Europën më të dobët përballë Kinës", "Financial Times" shton se "Paris sqaron se do të shikonte tek vetoja një mundësi për të rishikuar regjimin e konkurrencës së BE-së". Jo vetëm që gjermani Peter Altmaier zbulon se dëshiron t'i rrittojë rregullojt për konkurrencën në Bashkimin Europian, siç pohon Bruno Le Maire në televizionin "France 2", dhe në javët e ardhshme do të impenjohet me homologun e tij gjerman për të propozuar dusa modifikime në procedurën vendimmarrëse në lëmin e konkurrencës në gjirin e Komisionit, duke paraqitur mendimin e liderëve politikë, për të shmangur interpretime të thjeshtë teknike të rregullave europiane. Nga ana tjetër, Vestager mohon çdo kërcënim kinez në periudhë afatshkurtë në sektorin e hekurudhave, por joja, siç dihet mirë, nuk lidhet vetëm në kontinent, por suhomos në Afrikë, ku Kina po bëhet kapilare, duke zëvendësuar fuqitë e vjetra koloniale si partner referues për shtete subsahariane, nga Sudani tek Etiopia.

Marrë nga Business Insider, Bota.al

BOTIMI

Botohen në Kroaci katër romane të Luan Starovës

Shtëpia botuese e njohur kroate, "Tim-Press" me qendër në Zagreb, sapo ka publikuar në një vëllim të përbashkët dy romane të shkrimtarit të mirënjohur, Luan Starova. Vepra e këtij autori të shquar po botohet gjerësisht kohët e fundit jo vetëm në gjuhët e rajonit ballkanik, por edhe në ato të Europës, në të cilat mbërritja e këtij shkrimtari është përjetuar sipas fjalëve të filozofit dhe sociolog francez të njohur ndërkombëtarisht Edgar Morin, i cili shkruan: "Franca ka zbuluar me habi dhe me emocion shkrimtarin Luan Starova, romancierin e papërsëritshëm, të veçantë si ai, të paklasifikueshëm dhe megjithatë, të mirëvendosur, të mirëankoruar".

Bëhet fjalë për romanet "Koha e dhive" dhe "Kthimi i dhive". Nuk është hera e parë që romani kult i Starovës "Koha e dhive" botohet në gjuhën kroate. Kjo veprë e publikuar deri më sot në 20 gjuhë të botës, është publikuar në Kroaci edhe dy dekada më parë, si pjesë e edicionit të mirënjohur "romanet-hit".


Pritja e jashtëzakonshme që iu bë asokohe këtij romani në botimin e tij të parë zgjoi kureshtjen edhe për botimin e romanit të dytë, titulluar "Kthimi i dhive". Në të vërtetë, kjo zgjidhje e shkëlqyer editoriale bën të mundur që veprat të funksionojnë si një vijimësi e pandërprerë dhe si vepra në funksion të njëra-tjetrës. Dihet tanimë se romani "Koha e dhive" u prit mjaft mirë jo vetëm nga lexuesi, por u vlerësova lart edhe nga emrat më të shquar të kritikës së kohës. Mes tyre ishte edhe studiuesi dhe shkrimtari Predrag Matvejevi? e përcollti kështu botimin e librit: "Kjo veprë që lind në kohën e çarjeve ideologjike, ia del të shpërfaqë shumëçka prej kuptimit të kufizuar të realitetit që mund të jetë magjik si tek G. G. Marquez". Po ashtu, romancieri i njohur Erik Faye thekson në artikujt e tij kushtuar krijimtariisë së gjerë të Luan Starovës se, "letërsitë e Ballkanit na kanë dhuruar përherë perla të vërteta, si romani i Starovës 'Koha e dhive'. Lexuesit e Kadaresë, Peki?it ose Stepanovi?it, në romanet e tij do të gjejnë edhe një dritare në kullm, të hapur drejt motiveve". Po ashtu, akademiku Georgi Stardellov, ndërmjet tjerash shkruan për këtë roman: "U rrëmbeva që nga leximi i parë i dorëshkrimit, jo vetëm nga origjinaliteti i temës së tij, jo vetëm nga shtresat e shumta kuptimore dhe etike, por edhe nga shkrimi artistik, në të cilin ndërthuren realja me irealen, historia dhe poezia, tragjedia dhe parodia, realista dhe fiksjoni, epika dhe lirika, ajo melankolia andriçiane dhe ajo ironia e heshtur dhe e njohur çinogoviane, e gjitha e amalguar në një

"Starova, njësoj si Margerit Jursenari, që shkruan dhe dëshmon para se apokalipsi të zhbëjë reliket"



tërsi komplekse artistike dhe estetike". Në parathënien e botimit grek, Vasilikos, i njohur edhe si skenarist i filmit të famshëm të Kosta Garvrasit "Z", mes të tjerash, theksoi: "E lexova me shumë kënaqësi romanin 'Koha e dhive'. Në veçanti më befasoni simbolika dhe butësia e romanit. Është romani i parë që kam lexuar prej Luan Starovës. Ai ka cilësitë e një shkrimtari të lindur. Jam i lumtur që lexova një libër të bukur për Ballkanin tonë të dashur". Shtëpia botuese "Tim-press" botoi më herët në gjuhën kroate edhe romanin "Erveheja - libri për një nënë", libër ky i shpallur si romani më i mirë i vitit 2005. Romani "Erveheja..." u prezantua përpara publikut lexues të Zagrebit. Në përrimin e tij, mes shumë emrave të tjerë, foli edhe shkrimtari i njohur në mbarë rajonin, Milenko Jergovi?. Romani u prezantua me sukses edhe në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Pula, ku mori pjesë edhe autori. Për këtë veprë, shkrimtari i mirënjohur francez, Filip Delavo, shkruan: "Në sagën ballkanike paraqitet figura e bukur dhe diskrete e nënës Ervehe, shoqërujesja e lexuesit të madh, përherë në shërbim të librave, por edhe si një vitore e rrallë e mbijetesës së familjes. Starova, njësoj si Margerit Jursenari, që shkruan dhe dëshmon

“
 Autori i këtij romani zbulon se udha e ngjallave është më e vjetër se njeriu, se ajo ekzistonte përpara lindjes së njeriut, prandaj çdo pengim i saj do të jetë tragjik për të. Në këtë udhë të botës ngjallat nisen në të njëjtën mënyrë drejt Liqenit, arrijnë nëpërmjet lumenjve në det dhe prej atje shkojnë në Oqeanin Atlantik.



para se apokalipsi të zhbëjë reliket, arkivat e mbrame, gjurmët e venitura të rrugëtimitve". Deri më sot romani "Erveheja" është përkthyer në gjuhën gjermane, turke dhe bullgare. I njëjti botues (Tim-press), në vitin 2018 botoi të përkthyer në kroatisht edhe romanin e katërt të Luan Starovës "Dashuria e gjeneralit" (Generalova ljubav), veprën e frymëzuar nga ngjarjet ballkanike në kohën e Luftës së Parë Botërore. Kjo veprë e shquar u botua fillimisht në periudhën e shënimit të përvjetorit të 100 të Luftës së Madhe (Lufta e Parë botërore). Për këtë veprë u shpreh sërisht Predrag Matvejevi?, i cili ka shkruar: "Ky është roman falënderimi për përfaqësuesit e ndershëm dhe të urtë të Francës, të cilët në një periudhë të rëndësishme historike, kur hidheshin themelet e shtetit shqiptar, me guxim dhe të vetëdijshëm e ndihmuan Shqipërinë. Për këtë, dimensionin historio-grafik i romanit nuk është vetëm plotësim faktografik i personalitetit të Babait... Krëfimi mbi dashurinë e komandantit Eduard Mortie dhe shqiptares Atina Lazarit meriton rreth të gjerë lexuesish". Ndërkaq, shkrimtari i njohur maqedonas, Gane Todorovski, me rastin e botimit të romanit "Dashuria e gjeneralit", në parathënien e veprës thekson: "Në

romanin 'Dashuria e gjeneralit' ka një çiltërsi të jashtëzakonshme shpirtërore, një guxim kërkëzhsh, madje dhe një evrocentrizëm tërëhjekës, por ka edhe pozicione morale që lënë mbresë të fuqishme. Mbi të gjitha, romani shpërfaq të dhënë në Ballkanin nuk është vetëm vend përplasjesh etnike e religjioze, por edhe vend kulturash të ushqyera nga Lindja dhe Perëndimi. Veriu dhe Jug, duke mundësuar kësisoj jetën e fisme dhe të drejtë". Poeti i mirënjohur i maqedonas, Mateja Matevski thekson gjithashtu, duke vënë në dukje vlerat e mëdha të veprës: "Romani 'Dashuria e gjeneralit' i ngjan versionit shqiptar të romanit të Tolstojt 'Lufta dhe paqja'. Botimi i këtij katër romaneve të shkrimtarit të mirënjohur Luan Starova shënon depërtimin e mëtejshëm të "Sagës ballkanike" të autorit tonë të njohur në hapësirën kulturore dhe gjuhësore kroate, ashtu siç ndodh me botimin e shumë romaneve të kësaj sage në Francë, Gjermani, Itali, Turqi, Bullgari dhe në disa vende të tjera. Kjo, gjithsesi, është rezultat i qasjes origjinale dhe të sinqertë ndaj një materieje komplekse jetësore, aq të rëndësishme për të ardhmen e popujve ballkanikë dhe Evropën. Jo rastësisht, në Francë, ku gjer më tani janë përkthyer dhe botuar më



shumë romane të "Sagës ballkanike", kritika letrare parisienne (Livres Hebdo, 8 maj 2009) "ato i vlerëson ndër romanet më të arrirë evropianë". Kohët e fundit, krijimtaria e Luan Starovës u është bërë e njohur mjedisve të lexuesit përmes revistës "Poeteka", e cila në numrin e saj të 48-të, në verë të vitit 2018 i kushton rubrikën "Personalitet i ftuar" Luan Starovës, duke paraqitur të gjithë opusin prej 17 romanësh të çmuar. Pjesë e këtyre është edhe romani i mirënjohur "Shtegtimi i ngjalave". Në këtë roman ngjalat e zënë vendin e dhive, si mbretëresha të ujërave liqenore, udhëtimi i fshehtë i të cilave në pjesën ujore të planetit tonë ka domethënie thelbësore në zbulimin e harmonisë ndërmjet njeriut dhe natyrës. Udhë që bëjnë ngjalat duhet të jetë paradigmë e udhës, të cilën duhet ta bëjë njeriu në planetin tonë, udhë pa kufij dhe pengesa, udhë e lirë e lundrimit të tij në këtë botë...

Autori i këtij romani zbulon se udha e ngjalave është më e vjetër se njeriu, se ajo ekziston përpara lindjes së njeriut, prandaj çdo pengim i saj do të jetë tragjik për të. Në këtë udhë të botës ngjalat nisen në të njëjtën mënyrë drejt Liqenit, arrijnë nëpërmjet lumeneve në det dhe prej atje shkojnë në Oqeanin Atlantik, arrijnë afër brigjeve të Amerikës, pastaj nëpërmjet pasardhësve të tyre, kthehen përsëri nëpër udhën e njëjte në liqen. Kjo zgjat nga filllet e botës gjer në kohën tonë. Së këndejmi, përse njeriu nuk i bashkëngjitet udhëtimit të tyre, në atë udhëtim kthyes? Nuk duhet haruar se universi natyror dhe njerëzor është një dhe i vetëm dhe kjo që po ndodh në natyrë mund të krahasohet me frymën e njeriut. Kështu, për të, fenomenet natyrore ndodhin në të njëjtën mënyrë si edhe fenomenet e shpirtit njerëzor. Udhën e ngjalave babai e sheh nga prizmi mitik, përkatësisht metafizik, duke kërkuar dalje utopike, duke kërkuar vendin që nuk ekziston (toposin).

Në këtë betejë, ai e sheh një epope të madhërishe... Udhë e ngjalave për babain është inkarnacion i gjallë dhe organik i udhës së madhe ndërmjet vdekjes dhe jetës". Ky roman, i përkthyer në gjuhën frënge nga Klemán

d'Isartegi, nxitë gjerësisht vëmendjen e lexuesve dhe kritikëve të njohur të sagës ballkanike të Luan Starovës. Kështu, fituesi i njohur i çmimit Goncourt Moris Droun, për versionin francez të "Shtegtimi i ngjalave" shkruan: "Shtegtimi i ngjalave" ndërlihet dhe e plotëson me sukses "sagën ballkanike" të Starovës. Ajo është vepër alegorike, tejet përfaqësuese në letërsinë ballkanike. Romani shpërfaq një histori tragjike shekullore, që dëshmon për popuj me fate të rënda, i simbolizon familjet e shkulura me shpresa të përhershme kundërthënëse. Ai parashtron njëkohësisht pyetje ekzistenciale dhe metafizike dhe kjo nuk është meritë e vogël".

Në romanin "Shtegtimi i ngjalave" Edgar Moren nuk sheh "vetëm një vepër të shkëlqyer letrare, por edhe një krijim me dimensione historike, poetike dhe mitike", ndërkohë që Predrag Matvejević, autori i parathënies së këtij romani, e konsideron veprën si "dëshminë më të rëndësishme për kufijtë e Europës".

Brenda pranverës së këtij vitit, romani "Shtegtimi i ngjalave" do të jetë në duart e lexuesit shqiptar nga botimet "Poeteka", duke çelur kësajserinë e romanëve të Luan Starovës dhe rikthim në atdheun e gjuhës së tij. Më herët botimet "Poeteka" kanë publikuar edhe vëllimin me poezi të Luan Starovës "Kartagjena nuk mposhtet". Poeti i shquar Adonis në parathënien e shkruar enkas për botimin në shqip, shprehet: "Në të dukshmen, Luan Starova e vëzhgon të padukshmen. Duke udhëtuar, ai i prek kufijtë e vendqëndrimit... Luan Starova e vështron historinë dhe atë që është përtej saj, udhëtar në vende dhe në kohë. Po ku e shpie, ajo udhë në të cilën niset, ajo, fytyra më bredharake ndërmjet fytyrave që reflektohen në pasqyrën e udhës, udhëtar-banor në çrrënjosje, bredhje dhe dykuptimësi? Kështu poeti flet nëpërmjet Kartagenës dhe simbolikës së saj të atdheut-nënë të tij, të atyre gjërave që i ka të afërta, ndonëse jeton në çuditshmëri. Ai flet për të tanishmen duke përziatur mbi të kaluarën.

(Përgatiti Silvana Leka)

FILMI

"Një krim ndaj artit" dhe marrëveshja me borgjezinë

Fatmira Nikolli

Galeria "Zeta ka" shfaqur javën e kaluar filmin "A Crime Against Art" (Krim ndaj artit), një dokumentar nga Hila Peleg. Filmi është bazuar në gjyqin e Madridit të Anton Vidokle dhe Tirdad Zolghadr. "A Crime Against Art" (Një krim kundër artit), është një film i bazuar në gjyqin e inskenuar brenda një panairi arti në Madrid, në shkurt të vitit 2007. Gjyqi, frymëzuar nga imitimet e gjyqeve të organizuara nga Andre Breton në vitet 1920 dhe 1930, ngre një sërë pyetjesh polemizuese lidhur me botën e artit bashkëkohor: marrëveshjen e fshehtë me "borgjezinë e re", instrumentalizimin e artit dhe institucioneve të tij, format e mundshme të shprehjes artistike në të ardhmen dhe tema të tjera përkatëse. Gjyqi fillon me supozimin se është kryer një krim, por natyra e tij dhe provat janë iluzive dhe asnjë viktimë nuk është paraqitur. Dëshmitë dhe hetimet bëhen një përpejke e vazhdueshme e gjyqtarit (Jan Verwoert), prokurorëve (Chus Martinez and Vasif Kortung) dhe avokatit mbrojtës (Charles Esche), për të qartësuar natyrën e misterhme të "kriminalit ndaj artit". I inskenuar si një sallë gjyqi televiziv dhe i filmuar nga 4 kamera, filmi prezanton një version përmbledhës në 100 minuta të gjyqit. Një ndërthurje mes performancës, leksionit dhe kontekstit të gjykatave ngre pyetje të shumfishta për praktikën e artit që bazohet në hulumtime, si dhe në natyrën e artit në epokën e prodhimeve jomateriale. Me anë të vetakuzës - diçka e ngjashme me atë që intelektualët e artit do t'i referoheshin si reflektim - i gjithë diskutimi në sallën e gjyqit papritmas bëhet kundër-intuitiv dhe deri diku krijues. Për shembull, ka momente në të cilat prokurorët (Vasif Kortung nga Platform Garanti Qendra e Arteve Bashkëkohore, Stamboll dhe Chus Martinez nga Frankfurtur Kunstverein) e mohojnë akuzën e vetënegocimit të shprehur më parë nga dy të pandehur. Debatet pastaj rrotullohen rreth temës nëse Zolghadr dhe Vodokle e zvogëlojnë hapësirën e praktikës së artit jo për shkak të bashkëpunimit me "borgjezinë", por për shkak të thjeshtimit të nocionit të borgjezisë. Megjithatë, në kontrast me kritikën e vërtetë (e cila i dhemb), të gjitha akuzat kritike në një skenë, në një ditë të gjatë përfshihen brenda performancave

"Vdekja" e (mendimit të) një intelektualit



Hila Peleg

A CRIME AGAINST ART

gjysmëjuridike. Detyra këtu, pra, kthehet në mbajtjen e topit mes prokurorit dhe mbrojtjes. Nocioni i gjykimit duket se ka të bëjë më pak me të vërtetën, se sa me ritmin dhe estetikën. Performanca kolektive del me nocionin e paqëndrueshmërisë, ku akuzat kritike nuk mund të jetë më efektive siç ishte dikur, prandaj justifikon natyrën e gjyqit të Madridit, ku kritikant bëhen thjesht emblema dhe vetëreflektim; si retorikë verbale dhe ku askush nuk rrezikon veten. Në esencën e saj, përtej kritikës së pakët, performanca e gjykatës ka vënë në dukje fundin, "vdekjen" e një intelektualit për sa kohë kritikant artistike nuk mund të funksionojnë më si dikur dhe prandaj ka një divorc njohës mes kritikizmit dhe krijimtarisë në kuptimin që ata nuk duhet domosdoshmërisht të kryqëzojnë njëri-tjetrin në një prodhim artistik.

AUTORJA

Hila Peleg është një kuratore dhe regjisorë e cila jeton në Berlin, Gjermani. Peleg ka kuruar ekspozita solo, ekspozita kolektive (në shkallë të madhe) dhe ngjarje kulturore ndërdisiplinore të arteve pamore, filmit dhe arkitekturës, në institucione publike në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Ajo është gjithashtu e njohur për punën e saj si regjisorë e vlerësuar me çmime për filmat dokumentarë "A Crime Against Art", 2007, "Space Signature", 2016. Filmat e Peleg janë dokumentarë të bazuar në vëzhgimet, që trajtojnë konventionet dhe debatet në lidhje me hapësirën institucionale të artit. Hila Peleg ka kuruar projekte të

shumta ndërdisiplinore dhe ekspozita për institucione të tilla si KW (Berlin), Iniva (Londër), Haus der Kulturen der Welt (Berlin) dhe Center Pompidou (Paris). Në vitin 2010 ajo themeloi Forumin e Dokumentarit të Berlinit, një event i përdyvitshëm, i nisur në Haus der Kulturen der Welt, kushtuar prodhimit dhe prezantimit të praktikave dokumentare bashkëkohore dhe historike në një kontekst ndërdisiplinor. Ajo ka qenë drejtorja artistike e Forumit Dokumentar të Berlinit deri në vitin 2014. Peleg ka qenë bashkëkuratore e Manifesta 7 (Trentino-Alto Adige/Südtirol, 2008) dhe kuratore e programit të filmit në Bienalen e fundit të Shangaist (2014). Kohët e mëtejshme ajo ka qenë kuratore e "Documenta 14" (Athinë dhe Kassel, 2017), me fokus në programet e filmit dhe instalimet e projekioneve në shkallë të madhe në Athinë dhe Kassel. Ajo gjithashtu krijoi programin televiziv javor të "Documenta"-s, KEIMENA, transmetuar në kanal televiziv publik të Greqisë, ERT. Peleg është koordinatorë e librit "Documentary Across Disciplines", MIT Press, Cambridge, MA dhe Londër, HKW, Berlin, 2016.

Në role ishin: Jan Verwoert-gjykatësi, Anton Vidokle & Tirdad Zolghadr - të akuzuarit, Chus Martinez & Vasif Kortung-prokurorët, Charles Esche- mbrojtja; Maria Lind & Anselm Franke-dëshmitarë; Setareh Shahbazi-artisti, Keti Chukhrov- pjesëtar i publikut. Ky film u mundësua nga kortezia e Hila Peleg dhe Bureau Des Videos.

Opinion i Ditës

NATO në epokën e Putinit dhe Trumpit

Nga David Reynold

(vijon nga faqja 1)

... vitet 1950. "Nëse për 10 vitet e ardhshme - i tha një miku të tij në shkurtin e vitit 1951 - të gjitha trupat amerikane të stacionuara në Evropë për qëllimin e mbrojtjes së kombeve atje, nuk do të jenë rikthyer në SHBA, atëherë ky projekt do të ketë dështuar!".

Ajzenhauer këmbënguli se SHBA-të "nuk mund të jenë një Romë moderne, që ruan i kufijtë me legjionet e saj". Filozofia e tij ishte e ngjashme me atë të Hofmanit, administratorit amerikan të Planit Marshall që thoshte: "Ta bëjmë Evropën të ecë me këmbët e saj!".

Pse atëherë, ka qenë kaq e vështirë që Evropa të qëndrojë mbi këmbët e veta? Dhe pse Amerika ka zgjedhur të mbajë Evropën mbi shpinën e vet gjithë kësaj kohe? Me NATO-n tashmë në moshën e pensionit, vlen të gjurmohet evolucionin e aleancës gjatë Luftës së Ftohtë dhe pas rënies së Bashkimit Sovjetik.

E gjitha nisi si një traktat dhe jo si një aleancë. Ky dallim, shpesh i injoruar, është i rëndësishëm. Administrata "Truman" shpresonte që ndihma e Planit Marshall do të rikthente prosperitetin dhe vetëbesimin e Evropës Perëndimore përballë kërcënimit komunist, si nga Bashkimi Sovjetik, ashtu edhe nga partitë komuniste perëndimore, veçanërisht në Itali dhe Francë.

Nënshkrimi i Traktatit të Atlantikut të Veriut ishte në fakt një revolucion në politikën e jashtme të SHBA-ve. Ajo reflektoi jo vetëm gjendjen alarmante të marrëdhënieve sovjetiko-amerikane në vitet 1948-1949, por edhe ndryshimin e mendësive zyrtare amerikane. Kapitullimi i Francës dhe sulmi ndaj Pearl Harbor, i bindi politikëbërësit amerikanë, se në epokën e lindjes së fuqisë ajrore, Shtetet e Bashkuara nuk ishin më të sigurta pas barrierave të tyre tradicionale oqeanike dhe më në veçanti, se ajo duhet të luante një rol aktiv në punët e Evropës.

12 nënshkruesit origjinalë - Amerika, Kanadaja dhe 10 shtete të Evropës Perëndimore - ranë dakord ta trajtonin një sulm ndaj njërit anëtar, si një sulm mbi të gjithë: parimi i sigurisë kolektive, i mishëruar në nenin 5 të traktatit. Por secilit shtet iu lejua ta "ndërronte" një veprim të tillë, nëse e quan të nevojshme" respektimin e këtij detyrimi: pra nuk ishte një zotim automatik për të përdorur forcën.

Ajo që ndihmoi për ta shndërruar traktatin në një aleancë ushtarake, ishte lufta e Koresë. Pustimi i Koresë së Jugut nga Veriu në qershorin e vitit 1950 u njoh si diçka që Stalini duhet ta kishte autorizuar dhe mbështetur. Pati një frikë, se radhën mund ta kishte Evropa Perëndimore. Në atë



kohë, SHBA-të kishte në Evropë vetëm 2 divizione ushtarake.

Pas një debati të madh politik gjatë dimrit të viteve 1950-'51, Shtetet e Bashkuara vendosën të angazhojnë 4 divizione luftarake në Evropën Perëndimore dhe të ngrënë një strukturë të përshtatshme komanduese nën një Komandant Suprem të Forcave Aleate të Evropës - i cili do të ishte gjithmonë një amerikan.

Në këmbim të këtij angazhimi të pashembullt, për paqen në Evropë dhe sigurinë e Evropës Perëndimore, administrata e Trumanit kërkoi që edhe aleatët të bënin diçka më shumë. Në veçanti, ajo kërkoi riarmatim të Gjermanisë Perëndimore, por kjo ishte një anatemë për francezët pas 3 luftërave të tmerrshme kundër gjermanëve në 80 vjet: 1870, 1914 dhe 1939.

Debati mbi këtë çështje u zvarrit për 4 vjet dhe u dëshmuua si një moment vendimtar për marrëdhëniet transatlantike. Një mundësi ishte të zbatohej për mbrojtjen evropiane, logjika integruese e planit "Shuman" të vitit 1950, që përfundimisht i hapu rrugën krijimit të Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut dhe më pas Komunitetit Ekonomik Evropian (EEC), që u krijua më 1958.

Por, ideja një Komunitet Evropian i Mbrojtjes (EDC) u bllokua në vitin 1954 në Asambledë Kombëtare të Francës, nga një aleancë mes gollistëve dhe komunistëve. Në fund, riarmatimi i Gjermanisë Perëndimore vazhdoi me kushtin që forcat e saj të armatosura të ishin tërësisht të dedikuara për NATO-n, në një kohë që eliminoi të gjitha armët e saj atom-

ike, biologjike dhe kimike.

Republika Federale u pranua zyrtarisht në NATO në majin e vitit 1955. Sovjetikët u kundërpërgjigjën, duke formuar me satelitët e tyre Organizatën e Traktatit të Varshavës. Gjatë Luftës së Ftohtë, NATO përjetoi dy kriza të brendshme. E para u shkaktua nga presidenti francez, Sharl de Gol.

Me synimin për të rindërtuar madhësinë e vendit pas disfatës poshtëruese të vitit 1940, ai sfidoi dominimin amerikano-britanik të aleancës dhe kur u kritikua, e nxori gradualisht Francën nga komanda ushtarake e NATO-s. Dhe pastaj në marsin e 1966-ës, De Gol i kërkoi presidentit amerikan, Lindon Xhonson, që deri në prillin e 1967-ës, të gjitha trupat amerikane dhe ato të NATO-s duhej të tërhiqeshin nga Franca.

NATO e përfundoi tërheqjen brenda vitit, duke zhvendosur selinë e saj nga Versaja në Mons të Belgjikës. Kriza e re e brendshme e aleancës u përqendrua më shumë në Republikën Federale të Gjermanisë. Nga fundi i viteve 1970, udhëheqësit e NATO-s kishin frikë nga vendosja e raketave të reja sovjetike me rreze të ndërmjetme SS-20 në Evropën Lindore.

Në kundërpërgjigje, udhëheqësit e NATO-s ranë dakord të vendosnin armë të reja të SHBA-ve në Evropën Perëndimore. Vetëm 4 nga 12 anëtarët evropianë të aleancës, qenë të gatshme të pranonin raketat, kryesisht për shkak të protestave të brendshme. Opinioni gjerman ishte veçanërisht shumë i ndarë dhe presionet e rrëzuara qeverinë e koalicionit të kancelarit Helmut Shmidt, arkitekti kryesor evropian i "politikës së

strategjisë së dyfishtë".

U deshën dy liderë konservatorë të fortë - Helmut Kol në Gjermani dhe Margaret Theçer në Britani, që raketat të vendoseshin në këto 2 vende në vitin 1983. Zbatimi i suksesshëm i strategjisë së dyfishtë në fillim të viteve 1980 ndihmoi në ruajtjen e unitetit të NATO-s.

Por, ç'mund të thuhet për prioritetin kryesor: frenimin e rusëve? Kur Pakti i Varshavës u shkatërrua, NATO foli për shndërrimin e vetvetes në më shumë se sa një "organizatë politike". Deklarata e saj në Londër në korrikun e 1990 foli për ndërtimin e "partneriteve të reja, me të gjitha kombet e Evropës".

Në atë pikë nuk kishte një debat publik rreth zgjerimit të NATO-s, përtej marrëveshjes që ish-Gjermania Lindore do të bëhej pjesë e zonës së NATO-s, sapo të inkomporohej në Republikën Federale. Gjatë negociatave të vështira rreth bashkimit gjerman, Gorbacovi nuk arriti të këmbëngulte për ndonjë angazhim të detyrueshëm, sipas të cilit NATO nuk do të zgjerohet drejt lindjes.

Pas kolapsit sovjetik, kjo çështje u bë urgjente gjatë presidencës së Bill Klintonit në SHBA. Por, prioriteti i Departamentit të Shtetit dhe Pentagonit, ishte mbështetja e procesit të brishtë të reformave në Rusi, dhe ndihma për rizgjedhjen e Boris Jelcinin në vitin 1996.

Akti balancues i Uashingtonit, u pasqyrua në ofertën e statusit të Partneritetit për Paqe për anëtarët aspirantë në vitin 1994 dhe krijimin e një Këshilli të Përhershëm të Përbashkët midis

NATO-s dhe Rusisë në vitin 1997. Por pranimi i Polonisë, Hungarisë dhe Republikës Çeke në 50-vjetorin e NATO-s në prillin e 1999-ës, u perceptua në Moskë, si një sfidë ndaj statusit të Rusisë si një fuqi e madhe.

Edhe më e urryer për Kremlinin ishte pranimi i 7 shteteve të tjera të Europës Lindore në vitin 2004, përfshirë Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë - të cilat ishin aneksuar me forcë në BRSS prej vitit 1940 deri në 1991.

Vladimir Putin - pasardhësi i Jelcinin që nga viti 2000 - nuk bëri asnjë protestë të zëshme dhe Rusia vazhdoi të merrte pjesë në aktivitetet të ndryshme partnere me NATO-n, të tilla si stërvitjet e përbashkëta ushtarake. Në fakt, Putini po përpigjej të punonte ngushtë me Xhorxh Bushin në "Luftën kundër Terrorit", pas sulmeve të 11 shtatorit 2001.

Ai shpresonte të rindërtonte statusin e fuqisë së Moskës dhe të siguronte një dorë të lirë pranë lagjes ruse. Nga 60-vjetori i saj në vitin 2009, NATO duket se e kishte fituar Luftën e Ftohtë, pa gjetur një rol të ri për veten. Dhe në vitin 2019, shumë komentues po pyesin nëse Lufta e Ftohtë u mbyll realisht apo jo, duke pasur parasysh konfrontimin në rritje me Rusinë e Putinit pas pushtimit prej tij të Krimesë dhe pjesëve të Ukrainës (partner i NATO-s); përpjekjet e tij të vazhdueshme për të destabilizuar shtetet baltike dhe përdorimin e gjerë të sulmeve kibernetike, për të minuar proceset demokratike.

Putin do të testojë versionin e përditësuar të kontrollit të aleancës, por gjithashtu kërkon një kapacitet të dyfishtë për dialog - në mënyrë që të përfitojë nga fakti që shoqëria ruse, nëse jo politika e saj, ka ndryshuar rrënjësisht nga Glasnost i Gorbacovit. Por, mbijetesa e epokës së Trump, mund të jetë edhe më sfiduese.

Presidenti amerikan ka folur në mënyrë të përsëritur për largimin nga aleanca dhe ditëlindja e 70-të e NATO-s në Uashington në muajin prill, është reduktuar qëllimisht në një ngjarje të ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare. Ndërkohe, thirrjet e nëntorit të vitit 2018 nga Emanuel Makron dhe Angela Merkel, për një ushtri evropiane si "një plotëues për NATO-n", janë pa ndonjë domethënie.

Ata nuk arrin të trajtojnë si çështjen bërthamore, ashtu edhe atë gjermane. Angazhimi i liderëve të NATO-s në vitin 2014 për të rritur shpenzimet e mbrojtjes kombëtare në 2 për qind të PBB brenda një dekade, është arritur deri më tani nga vetëm 7 nga 29 vendet anëtare, me Gjermaninë që është një nga pengesat kryesore. Ndoshta sfida më e madhe e NATO-s në dekadën e saj të tetë nuk është frenimi i rusëve, por mbajtja e amerikanëve në gjirin e aleancës.

Marrë me shkurtime nga "New Statesman" - "Bota.al"

Opinioni *i* Ditës

Dëshirat e 1 prillit

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... i programuar t'i shpenzojë këto para (në vend që t'ua japë oligarkëve tanë ndërtues) për tre vjet 2019-2021 për bujqit, që të mos derdhin qumështin dhe të mos hedhin mollët dhe qepët e kalbura në kanal. Si edhe për sipërmarrësit e vegjël në turizëm, për të zgjeruar shtëpitë, bujtinat dhe për të pajisur sa më mirë plazhet e tyre private, pyjet, lëndinat, si dhe restorantet e kafenet. Se rrogat dhe pensionet u rritën që në datën 1 janar 2019 me buxhetin e ri! Se qeveria po shikon të ndërtojë vërtetë rrugë, por ama ato rrugët e ngushta që të çojë punëtorët në qendrat prodhuese të vendit, aty ku del vlera e shtuar e tij dhe lind shpresa për zhvillim, eksport dhe turizëm. Se po kjo qeveri ua preu si shtëpat Damokleu në mes ish-ministrave të vet serialin dhe drekave dhe darkave me investuesit vendës që e dinë mirë pagesën e 20 përqindëshit nën dorë për çdo tender të fituar. Ose çdo lloj favorit tjetër "të vockël". Madje, edhe se si jepet kjo mirënjohje oligarku në apartamente, vila, llogari bankare jashtë vendit ose në dhuratat të shtrënjta (të tipit autoveturë 'BMW' 80 mijë euroshë kur ia shpëton parajsës fiskale 56 milionë euro në dy muaj, në vend që t'i kalonin ato para buxhetit të shtetit për të rritur rrogat). Pashë se më në fund hemorragjia e emigracionit nga mungesa e besimit se ky vend bëhet, u ndal. Se Shqipërisë nuk do t'i largohen me 60 mijë veta në vit, me shpresë të dredhur në gjë se mos gjejnë punë në Gjermani dhe i mbajnë aty. Se partitë kryesore arritën marrëveshjen për zgjedhjet vendore, për votimin elektronik dhe minimizimin e rasteve të shitblerjes së votës. Duke braktisur llogoret e vjetra 27-vjeçare. Duke harruar fjalën e sharjeve dhe akuzave të ndërsjella për estradë



televizive. Duke risjellë opozitën në parlament, ngaqë dorëheqjet e deputetëve të saj nuk e kishin të shkruar shprehjen vrastare "e parevokueshme". Duke fshehur dhunën mbi institucionet dhe mbi protestuesit. Se partitë harruan të shajnë njëra-tjetrën në Bruksel. Se nënshkruan një pakt dhe nxorën një rezolutë në Kuvend, ku përkrahnin pa rezervë integritimin e vendit dhe hapjen e bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, dy muaj nga vendimi i 29 qershorit i Parlamentit Evropian. Se bandat ranë dakord të lanin hesapet mes tyre në Barcelonë, Bruksel apo Londër, pa përgjakur me Shkodrën apo Elbasanin. Se përfaqësi studentësh nënshkruan me kryeministrin një

marrëveshje që gradualisht kontributi i buxhetit të shtetit për arsimin të shkojë 4 për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit brenda 10 viteve të ardhshëm, duke gjetur së bashku mënyrën se si t'ua bëjnë vetingun pedagogëve matrapazë ose të paaftë. Se të 70 milionë eurot e Fondit Shqiptar të Investimeve shkuan si me magji këtë vit për rinovimin e urgjencave të spitaleve rajonale dhe atyre periferike, në vend që të bëhen beton, zbulurim dhe lule në qendra qytetesh. Se lungomare në Vlorë nuk bie më erë fekale kur fryn erë nga deti, ngaqë kanë harruar të bëjnë kanalet e ujërave të zeza poshtë betonit masiv. Se socialistët më në fund braktisën ideologjinë e pastër të taksës progresive si taksë

e drejtë dhe kuptuan se investuesit e huaj të rëndësishëm, zëvendësues të TAP dhe të hidrocentraleve të Devollit mund t'ua sigurojnë shqiptarëve vetëm nëse ulin peshën e taksave të vendit, duke e bërë menjëherë taksën mbi fitimin 10 për qind nga 15 për qind që është tani. Se vendosën të mos bëjnë më asnjë përjashtim nga ligji për procedurat tatimore të Republikës së Shqipërisë, të amenduar ose ndryshuar 138 herë në 10 vjet, paqëndrueshmëria e të cilit iu pjell ankthet e gjithë atyre të huajve që guxojnë të rrezikojnë paratë e tyre me investime tek ne. Se strukturat e reja të reformës në drejtësi nisën nga arrestimet e para të bujshme. Dhe u ngrita nga krevati i qullur në djersë. Ishte data 1 prill!

HOROSKOPI

DASHI
Përpikuni të investoni më shumë të gjërat që ju sjellin lumturi, duke i lënë pak pas dore angazhimet në punë. Shpenzoni kohë me njerëz, të cilët ju falin dashuri. Do të kuptoni sa shumë lumturi do të merrni.

DEMI
Rruga më e fiksuar për të shkëlqyer është komunikimi me të tjerët. Nëse jeni në kërkim për të mësuar më shumë në lidhje me mundësitë e karrierës suaj, atëherë ju duhet të flisni më tepër veçanërisht me kolegët dhe njerëzit që keni pranë.

BINJAKET
Keni një tendencë për të ndërtuar mure rreth vetes sa herë që përballeni me rrezik. Ka ardhur koha që të përballeni me sfidat, sado të vështira që të jenë ato. Në dashuri duhet t'i thoni gjërat troc.

GAFORJA
Mos harroni se vetëm ju dhe askush tjetër nuk është përgjegjës për jetën tuaj sociale. Sa i përket profesionit, keni nevojë që të angazhoheni më shumë për të pasur sukses. Në dashuri, gjërat duken në ngjercë.

LUANI
Nëse jeni duke u përpjekur që të ndihmoni një mik, sot do të merrni disa informacione të vlefshme, që do ta bëjnë shumë më të lehtë. Dhënia e ndihmës fillon me dëgjimin dhe respektimin e asaj që dikush ju thotë. Në dashuri, duket diçka e re në sfond.

VIRGJERESHA
Sot është dita për të nisur një marrëdhënie flirtuese. Programoni datën e kafesës! Nëse jeni në një marrëdhënie, kërkonte një vend të ri argëtimi. Mos kaloni në monotoninë në raportin tuaj romantik.

PESHORJA
Kujtimet tuaja janë një mënyrë të mrekullueshme për t'ju treguar se çfarë është e rëndësishme në jetën tuaj. Nëse i konsideroni gabimet tuaja të së kaluarës përpara se të ndërmerri hapin tjetër, do të shmangni disa gracka serioze.

AKREPI
Kur një hesë bie ndesh me një tjetër, nuk mund të lejoni që ambicia juaj të përcaktojë prioritetet tuaja. Besnikëria duhet të jetë ajo që ju udhëzon. Mos harroni se duhet të flisni ballë për ballë me njerëzit për të zgjidhur problemet tuaja.

SHIGJETARI
Shpenzoni më pak në gjëra të cilat nuk ju nevojiten. Shenja juaj karakterizohet nga dëshira për të shpenzuar, por sot duhet të bëni një ndalesë dhe të mendoni për të ardhmen.

BRICJAPI
Kjo është një ditë e mrekullueshme për të filluar disa aventura të mëdha. Ju duhet të vendosni si prioritet disa udhëtime për të marrë më shumë frymëzim dhe energji të reja.

UJORI
Kufijtë që vendosni për të mbrojtur veten janë të përshtatshëm për atë që po kaloni tani. Në dashuri jo gjithçka po ecën me ritmet që do të donit, por shumë shpejt gjithçka do të stabilizohet.

PESHQIT
Nëse po kaloni momente jo shumë pozitive sa i përket dashurisë, ndryshoni taktikë. Ka ardhur momenti që të mendoni më shumë për jetën tuaj romantike. Në punë mund të kaloni disa momente delikate, që falë aftësive tuaja, do t'i kaloni me sukses.

KUKËSI NUK HEQ DORË

Një nga lojtarët më të spikatur të historisë së futbollit kuksianë në dy dekadat e fundit është padyshim Rraman Hallaçi. Kapiten dhe një karrierë e mbyllur në mënyrën me të mirë me një titull historik me skuadrën e qytetit, aty ku nisi që të luajë që në moshën 16-vjeçare. Në një prononcim për "Super-sport", Rraman Hallaçi,



Hallaçi: Do të vazhdojmë të luftojmë për titullin dhe Kupën

tashmë zv. trajner te Kukësi ka pohuar: "Shpresojmë shumë, matematika na lejon. Nuk na vjen mirë, sepse Partizani është i shkëputur shumë. Normalisht që edhe në po të ishim në pozitë e të kuqeve do të ishim më të qetë. Por, asgjë nuk ka mbaruar, gara ka edhe shumë

ndeshje". Sa i përket mundësive të Kukësit dhe kontingjentit, në rolin e specialistit, tashmë Hallaçi ka shtuar se: "Presidenti ka bërë investim shumë të madh, ka afruar lojtarë që për Superiore tonë janë luks. Por të gjithë të bashkuar duhet që të guxojmë". Kukësi barazoi

në Kukës 2-2. Lidhur me sfidën e kthimit, Hallaçi ka theksuar në fund të prononcimit se: "Sa i përket kupës, kemi dy rezultate, ndeshja e kthimit është në favorin tonë, por ne do të hyjmë në fushën e lojës për të fituar dhe të kalojmë më tej. Gara vazhdon për ne në kampionat, por edhe në Kupën e Shqipërisë për të dyja objektivat", - ka pohuar zv. trajneri i skuadrës së Kukësit, Rraman Hallaçi.

Vanda Nara kundër Spaletit: I kardit është gati të luajë

Nuk mund të dalin asnjëherë jashtë modës deklaratat e gruas dhe njëkohësisht agjentes së Ikaridit, Vanda Nara. Si zakonisht gjatë emisionit "Tiki Taka", Vanda nuk mund t'i shmangte pyetjeve rreth situatës që po shoqëron sulmuesin te Interi, teksa së fundmi Ikaridi është rikthyer të stërvitet me grupin, por sërisht kjo nuk i mjaftoi teknikut Luciano Spaletit për ta grumbulluar. Nara shtoi se Ikaridi ndihet gati për të zbritur në fushë dhe nuk mendon për polemikat, referuar fjalëve të Spaletit pas ndeshjes ndaj Lacios. "Mendoj se Mauro është rikthyer, por aktivizimi i tij varet nga trajneri. Një si Ikaridi është mësuar të dëgjojë shumë gjëra, por ai nuk mendon për polemikat, ndërsa përqendrohet të luajë, të shënojë dhe të ndihmojë Interin. Pres që tifozët t'i shprehin afeksinonin e tyre siç kanë bërë gjithnjë. Ikaridi i ka mbështetur gjithnjë shokët e skuadrës, si nga shtëpia edhe kur ka qenë në stadium, nuk është e nevojshme që ta shprehë vazhdimisht në rrjetet sociale", tha Vanda. Mbetet për t'u parë nëse Ikaridi do të grumbullohet për ndeshjen e radhës në kampionat, apo tekniku Spaletit do të mendojë ta ndëshkojë sërisht për sjelljen e kohëve të fundit.

Presidenti i kurbinasve, Pashk Laska, ia hedh me vetëm 3 ndeshje pezullim, 9 për Kleo Laskën

Disiplina "zhyt" Tiranën, por Kukësin veç e gjobiti!

Bardheblutë 4 ndeshje pa tifozë, Ngo 5 ndeshje



Jeton Selimi

Komisioni i Disiplinës pranë Federatës Shqiptare të Futbollit është mbledhur dje me urgjencë për të analizuar veprimet jospportive të konstatuara gjatë fundjavës në futbollin shqiptar. Në veçanti vëmendje ka pasur ndeshja mes Tiranës dhe Laçit, ku krahas kontesteve në fushë, pati edhe një përleshje në dhomat e zveshjes, ku kurbinasit qëlluan ndaj të paktën dy futbollistëve bardheblu. Kështu Komisioni i Disiplinës ka vendosur të dënojë me 4 ndeshje pa spektatorë në shtëpi, klubin e Tiranës, vendim ky që mund të përkethehet në mbyllje për të gjithë sezonin, të stadiumit "Selman Stërmasi" për bardheblutë. Po me 5 ndeshje është pezulluar edhe sulmuesi anglez i bardhebluve, Majkëll Ngo, ndërsa ndihmës trajneri i bardhebluve, Emanuel Egbo është pezulluar me dy ndeshje. Në këtë mënyrë, klubi i Tiranës duhet të bëjë llogaritë me mungesën e dy armëve të saj më të forta, sulmuesit anglez Ngo dhe tifozërisë bardheblu. Shumë më tolerante është treguar Disiplina ndaj presidentit të Laçit, Pashk Laska, të cilin e ka dënuar me vetëm 3 ndeshje, ndërsa të birin e tij, Kleo Laska e ka dënuar me 9 ndeshje, pra deri në fund të sezonit.



ÇFARË NUK SHKON

Goditja me shishe kokës e vijërojtesit Neritil Bregasi i ka kushtuar shumë sh-trenjtë Tiranës, që sheh t'i mbyllet stadiumi nga Komisioni i Disiplinës për 4 ndeshjet e radhës si pritës. Një vendim i rëndë ky, për

një ngjarje të rëndë, por që nuk është i barasvlefshëm me ngjarje të tjera të ngjashme këtë vit në Superiore, si ajo e Kukësi-Laçi po në fillimin e këtij viti, ku anësori Denis Rexhinja u godit në kokë nga tifozët, por verilindorët u ndëshkuan

vetëm me gjobë prej 200 mijë lekësh.
VENDIMET E DISIPLINËS:
1. KF "Tirana", për sjellje të gabuar të spektatorëve duke shkaktuar ndërprerjen e përleshjeve të lojës, në bazë të Nenit 66/3/b të KDS, dënohet me zhvillimin e 4 (katër) ndeshje pa spektatorë në stadiumin përkatës.
2. Lojtari i KF "Tirana", Michael Ayodeji Ngo, për sulm ndaj kundërshtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 48/1/e të KDS, dënohet me 5 (pesë) ndeshje pezullim nga aktivitetet.
3. Zyrtari i KF "Tirana", Emanuel Egbo, për protesta ndaj vendimeve të zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 56/1/a të KDS, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga aktivitetet.
4. Zyrtari i KF "Laçi", Pashk Laska, për sjellje jo sportive ndaj kundërshtarit të

ndeshjes, në bazë të Nenit 48/2/a të KDS, dënohet me 3 (tre) ndeshje pezullim nga aktivitetet. Në bazë të nenit 20 dhe 21 të KDS, zyrtarit i ndalohej hyrja në stadium, në dhomat e zveshjes dhe territoret përreth fushave të lojës apo stolat e rezervave.
5. Zyrtari i KF "Laçi", Kleo Laska, për sulm ndaj kundërshtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 48/2/b të KDS, dënohet me 9 (nëntë) ndeshje pezullim nga aktivitetet.
6. Zyrtari i KF "Laçi", Klevis Hima, për sulm ndaj kundërshtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 48/2/b të KDS, dënohet me 9 (nëntë) ndeshje pezullim nga aktivitetet.
7. FK "Partizani", paralajmërohet se në rast përsëritje të sjelljes së gabuar të spektatorëve do të jetë subjekt i masave ndëshkimore që parashikon Kodit i Disiplinës Sportive dhe rregulloret e tjera të FSHF.
8. KF "Vllaznia", paralajmërohet se në rast përsëritje të vonesave në fillimin e lojës do të jetë subjekt i masave ndëshkimore që parashikon Kodit i Disiplinës Sportive dhe rregulloret e tjera të FSHF.
9. Zyrtari i KF "Shënkoll", Albert Rrusti, për protesta ndaj vendimeve të zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 56/1/a të KDS, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga aktivitetet.
10. Zyrtari i KF "Vora", Rezart Maho, për protesta ndaj vendimeve të zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 56/1/a të KDS, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga aktivitetet.

HABIA

FSHF dhe Shoqata e Arbitrave nuk thonë asnjë fjalë

Edhe e hëna ka kaluar në qetësi për qeverinë e futbollit shqiptar dhe për Shoqatën e Arbitrave. FSHF-ja, prej kohësh ishte e shoqësuar për mungesën e policisë në stadione, duke ia veshur kësaj të fundit çdo ngjyrim dhune apo incidenti. Por, siç tregojnë faktet, edhe me rikthimin e uniformave blu, situata vijon të mbetet gjithnjë problematike. Në mbledhjen qeveri-federatë, u vendos që të dënohen me 3 vite burg tifozët që hyjnë në fushë, ndërsa nuk u tha asnjë fjalë për presidentët, lojtarët, apo zyrtarët që janë shkak të dhunës. Në Tirana-Laçi, shkakto-

nuk ishte tifozëria bardheblu. Ata bënë detyrën e tyre në shkallët e stadiumit. Anësori u godit nga një shishe e fluturuar nga tribuna qendrore, ku shpesh shkojnë gjithfarësoj "VIP"-sh që vetëshpallen të tillë për faktin se kanë disa para më shumë se të tjerët dhe ndihen të fuqishëm për të bërë ç'të duan. Më pas ajo që ndodhi në përfundim të ndeshjes në "Selman Stërmasi", tregoi edhe njëherë se janë klubet ata që nuk sillen si profesionistë dhe ata më me mungesë profesionalizmi i mbështet FSHF me përkëdheljet e vazhdueshme.

Gjithashtu, ishte sërisht rasti që Shoqata e Arbitrave dhe kryetari i saj, Tahir Kastrati, të reagonin, por asnjë fjalë për goditjen e Bregasit, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Qëndrim ky skandaloz i Kastratit dhe shoqatës së tij, që me këtë heshtje të pakuptimtë për të mbrojtur anëtarin e saj, të bën të mendosh se ajo që i ndodhi Eldorian Hamitit ishte vetëm një incident, që më shumë u shërbeu drejtuesve të futbollit dhe që u shfrytëzua nga ata, sesa vullnet për të ndëshkuar me të vërtetë dhunën në futboll dhe dhunuesit.

Brazilianët nuk po bindin


Juventus nxjerr në shitje Douglas Kostën dhe Aleks Sandron



bindur kanë qenë dy brazilianët, Aleks Sandro dhe sulmuesi Douglas Kosta. Mbrojtësi ka qenë larg prit-

shmërive, ndërsa në rast se do të paraqiten oferta konkrete atëherë Juventus do t'i vlerësojë seriozisht, teksa së fundmi për Sandron ka patur një interesim nga PSG. Sa i përket Kostës, anësori i sulmit në pjesën më të madhe të sezonit ka mbetur jashtë formacionit, si për shkak të penalizimeve, por edhe prej dëmtimeve, megjithatë interesi për Kostën është i lartë, teksa edhe klubi i Interit është mes klubeve që pretendojnë shërbimet e brazilianit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Riza aktor.
7. Një fjalë si hiç.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premton të bëhet as.
14. Janë fellnë... të zinj.
16. Ami i Maupassant.
18. Heroi i Emilio Salgarit.
19. Qe anarkist i famshëm rus
21. Një mungesë gjaku.
22. Susanna shkrintare
23. Të parat në cilësi.
25. Mbyllin një shtëpi.
26. Mbeten në fund.
27. Qëndër në kaos.
28. Ka bërë piktoreskë një i tillë
30. Inicialet e Camus.
31. Motra... e Kolë Idromenos
33. Një konfuzion total.
34. Rastet pa set.

- 36. Rastisin në krye.
37. Fillojnë detyrën.
38. Bektashi këngëtare.
39. Andrea aktore.
41. Sampras i tenisit.
43. Shkroi Korbi (indie).
44. Triolet e Triëndafië me kredi.
46. Kilmer aktor.
47. Në krye të robotëve.
49. Unë dhe ti.
50. Një mund të jetë fetar.
51. Stephane poet francez

VERTIKAL

- 1. Fillojnë praktikën.
2. Britma e Arkimedit.
3. Ekstre në trap.
4. Në fund të fundit.
5. Janë fjetoret e ushtarëve
6. Parket regjisor.
7. Vivaldi kompozitor.
8. Një shkop për karambol.
9. Janë firmat rentiere.
10. Një i fundit mbi të gjithë
11. Kufizojnë tatimet

- 13. Janë nomadë.
15. Panik pa kufij.
16. Fryn detin
17. Sidney regjisor i Serpico.
18. Jep alarmin.
20. Fillojnë gazet.
24. Janë llogari.
25. Alan regjisor.
29. Roman regjisor.
32. Eshhtë X ajo e sulmit.
33. Kafen të parat.
35. Një provë... inteligjence.
37. Një markë lap top.
40. Fillojnë matjet.
41. Rruga e Ferenc Molnar.
42. Qerre pa qe.
45. Fillojnë lirinë.
46. Fillojnë vallen.
48. Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- 1. Një doktor... i Fritz Lang
6. U paraprind hoteleve.
11. Kush nuk ka... nuk ha
13. Eshhtë djall
14. Një mund të ketë i rrallë.
15. Ishin perëndi të Samotrakias.
17. Institucione Botuese Autonome.
18. Eshhtë infeksion në bark
20. Fundi i një samurai.
21. Një markë kafeje.
22. Mbyllin një hark.
23. Mund të jetë emërore.
25. Ishte muzikanti që nuk përsiste.
28. Në krye të avokatëve.
29. Qerre pa qe.
30. Një pjesë e adoleshentëve.
32. Një banor imagjinari i planetit të kuq.


VERTIKAL

- 1. James, armiku i Sherlock Holmes.
2. Eshhtë edhe ajo saudite.
3. Imami aktore
4. I kanë çift turket.
5. Inicialet e Seagal aktor.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Në fund të lutjes.
8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinas.
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyteti i Besës.
24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
26. Njëllor për latinët.
27. Mund të bëjnë stil të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rrallë eshtë përgjysmë.
42. Nisur pa kufij.
45. Fillojnë mobilizimin.




- 7. Në fund të lutjes.
8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinas.
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyteti i Besës.
24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
26. Njëllor për latinët.
27. Mund të bëjnë stil të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rrallë eshtë përgjysmë.
42. Nisur pa kufij.
45. Fillojnë mobilizimin.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

Sudoku grid with numbers 6, 4, 1, 2, 9, 3, 7, 1, 2, 4, 9, 6, 5, 9, 8, 6, 7, 4, 5, 6, 7, 9, 3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

Sudoku solution grid with numbers 2, 4, 3, 9, 7, 1, 6, 8, 5, 6, 7, 5, 8, 2, 3, 1, 9, 4, 8, 9, 1, 5, 6, 4, 2, 7, 3, 7, 5, 2, 1, 4, 6, 8, 3, 9, 1, 6, 8, 7, 3, 9, 4, 5, 2, 4, 3, 9, 2, 5, 8, 7, 6, 1, 3, 1, 6, 4, 8, 5, 9, 2, 7, 5, 2, 4, 6, 9, 7, 3, 1, 8, 9, 8, 7, 3, 1, 2, 5, 4, 6

Argëtim filozofik

Të gjithë janë në gjëndje të nxjerrin përfundime, pak janë gjëndje të gjykojnë.

Dhuratat e vogla ruajnë miqësinë. Të madhajat, dashurin.

Të përbashkëta janë ato që bëjnë një marrëdhënie të këndshme, por dallimet e vogla janë ato që i japin interes.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

Cryptogram grid with letters K A F E T A L E N T, A D A M P A F T E R, T E T H E P A T I T I, E T H E R E T I K E, G K O M I T E T E T, O E K I P E T T F, R I K N E T T A P A, I O G C S T I L, K P S W I N G S L, E O P A T E N T A T, N A Y E U R A T, T Y M I P I R A T I

- Gjithmonë kur diçka vjen papritur në jetën tuaj, ikën në të njëjtën mënyrë !!!
- Ndershmëria, kryesisht, është më pak fitimprurëse se sa pandershmëria.
- Eshhtë e dhimbshme për ti thënë

- "lamtumirë" një personi që nuk do të të braktiste kurrë ... por më e dhimbshme
eshhtë ti kërkeshe një personi të qëndrojë duke e ditur se një ditë do të të braktisë!!!

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR



FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

